3. Rritja e motivimit për punë të nxënësve dhe arsimtarëve përmes përmirsimit të kushteve hapësiro teknike.	Sanimi i rrethojes së oborrit të shkollës	● Formimi i ekipit për punë. ● Ndarja e obligimeve të punës ● Dhënia e raportit dhe sugjerimeve nga ana e ekipit. ● Vendosja e rrethojës në oborrin e shkollës. ● Ngjyrosja e rrethojës dhe e dyerve hyrëse.	Arsimtarë mjeshtër	letra kompjuter printer fotokopje vegla për mjeshtër	Sipas nevojës	tetor 2024	Gzime Alili - drejtor	● mbledhje të ekipit një herë në javë - procesverbale nga mbledhjet e punës nga ekipi ● Raporte gjer te këshilli i arsimtarëve dhe drejtori ● fatura për materialet e blera ● verifikim vizuali gjendjes

6. Evaluimi i planeve të veprimit

Gjatë evaluimit të planeve të veprimit është përdorur strategjia dhe teknika për mbledhjen e informatave si vijon:

Definicioni	Niveli	Termini	Burimi i informatave	Metoda për mbledhjen e informatave
Shqyrtimi i planit të veprimit	Informatat hyrëse	janar-2025 korrik - 2025	Programi vjetor i shkollës	Shqyrtimi i informatave
Rrishikim i aktiviteteve të kryera	Procesi	janar - 2025 korrik- 2025	Koordinatorët e Projektit, personi përgjegjës për aktivitet, procesverbale dhe raporte për aktivitetet e kryera, aktivitet tjetër i dokumentuar si indikator për planin e veprimit	Intervist me persona përgjegjës, shqyrtim i informatave
Përqindja e aktiviteteve të bëra, arritja e qëllimeve afatshkurtra	Rezultatet	janar - 2025 korrik - 2025	Koordinatorët e Projektit, personi përgjegjës për aktivitet, procesverbale dhe raporte për aktivitetet e kryera, rezultate te anketuara me nxënës, prindër dhe arsimtarë	Intervistë me persona përgjegjës, intervistë me prindër, nxënës arsimtarë, anketa, shqyrtim i informatave, krahasim me indikatorë për sukses të paraparë me planin

Evalvimi i planeve të veprimit do të ofrojë informata dhe nota për:

- kualitetin e informatave hyrëse, në fakt të vet planeve të veprimit,
- procesi, në fakt procedurat për zbatimin e aktiviteteve të parashikuara;
- rezultatet, në fakt arritja e qëllimeve dhe efekteve afatshkurtra të cilat janë të parashikuara me realizimin e planit të veprimit.

Arritja e qëllimeve dhe rezultateve afatgjata nuk mundet të vërtetohen me këtë evalvim, për shkak të periudhës kohore në të cilën zbatohet (gjysëmvjetor dhe vjetor) dhe teknikave hulumtuese të cilat përdoren. Ato do të jenë të dukshme me evaluimin Integral nga ana e ISHA.

Evalvimin e planeve të veprimit do ta zbatojë ekipi për vetëevaluim i shkollës i përbërë nga: **Gzime Alili, Fatime Bexheti- Durmishi, Dukagjin Muharemi, Adile Abdii, Medina Alji, Arjeta Beqiri, Hana Xhaferi, Flutura Beluli.**

Evaluimi i vitit shkollor 2024/2025 është drejtuar kah përcjellja dhe vlerësimi i realizimit të planit zhvillimor, prioritetet dhe projektet të cilat realizohen në shkollë, të përshtatura me **planin për evaluim** si vijon**:**

Fusha e vlerësimit	Kriteret për sukses	Instrumentet	Indikatorët për sukses	Koha	Personi përgjegjës
Realizimi i mësimit obligativ dhe zgjedhor	● orë të realizuara	● e-ditari ● protokoll për mbajtje të orëve ●raporte për periudha kualifikuese - anketa	● sukses i përmirësuar ● orët e realizuara	XI, I, IV, VI	Gzime Alili - drejtor Fatime Bexhei-Durmishi- arsimtar mentor dhe nëndrejtor.
Realizimi i mësimit shtues dhe plotësues dhe programet jashtëmësimore	● orë të realizuara	● e-ditari ● përcjellje të orëve ● raporte për periudha kualifikuese -anketa	● sukses i përmirësuar ● orët e realizuara	XI, I, IV, VI	Dukagjin Muharemi - pedagog
Pjesëmarrja në gara	● rritja e numrit në pjesëmarrje nëpër gara	● përgatitja për mësim shtues ● e-ditari ● protokoll për mbajtje të orëve ● raporte për periudha kualifikuese ● raporte nga organizatorë të garave ● anketa	● sukses më i lartë në gara - orë të realizuara në orë plotësuese	XII, V, VI	Dukagjin Muharemi - pedagog
Përmirësimi i arritjeve të nxënësve	● rritja e suksesit të SHFK "Naim Frashëri" ● zvogëlim i numrit të nxënësve të udhëzuar për mësim shtues ● zvogëlim i numrit të këshillimeve të prindërve për sukses të ulët	● raporte për periudha kualifikuese ● analizë e suksesit ● instrumente për vlerësim formativ dhe sumativ ● anketa ● raporte nga këshillimet e prindëve me sukses të ulët	● sukses në periudha kualifikuese - analiza të suksesit ● numri i këshillimeve të prindërve për sukses të zvogëluar	XI, I, IV, VI	Medina Aliji - Psikolog

Fusha e vlerësimit	Kriteret për sukses	instrumentet	Indikatorët për sukses	Koha	Personi përgjegjës
Përparim në të arriturat e nxënësve	● zvogëlimi i dallimit mes notave të këtj viti dhe ato nga viti i kaluar	● raporti vjetor	● dallime **0,27**	VI	Dukagjin Muharemi - pedagog
Përdorimi i mësimit aktiv	● përmirsimi i komunikimit Përmirsimi i rregullshmërisë dhe të arriturat mesatare më të larta	● protokoll për rishikim të PVT, përgatitjeve për orë ● protokoll për rishikim të orëve ● raporte të periudhave kualifikuese -protokoll për rishikim të portofolios profesionale ● anketë	● sukses në periudha kualifikuese -analiza të suksesit ● numri i këshillimeve të prindërve ● punime në portofolin profesionale	XI, I, IV, VI	Medina Aliu - psikolog Mirije Kurtishi - mësimdhënëse
Përdorimi i TIK në mësim	● aktivitete hulumtuese në mësim ● mbikëqyrje ● pavarësim i shkollës në punë	● protokoll për rishikim të planeve për realizimin e ptogrameve mësimore, përgatitjeve për orë ● protokoll për rishikim të orëve ● raporte të periudhave kualifikuese ● protokoll për rishikim të portofolios profesionale ● anketë	● sukses në periudha kualifikuese ● analiza të suksesit ● punime të nxënësve ● punime në portofolin profesionale	XI, I, IV, VI	Fitore Selmani - mësimdhënëse
Zhvillimi profesional i kuadrit arsimor	● plan për ngritje profesionnale për zhvillim ● trajnime të kryera ● punime në portofolin profesionale	● protokoll për rishikim të përgatitjeve për orë ● raporte të periudhave kualifikuese ● protokoll për rishikim të portofolios profesionale ● anketë	● disa të punësuar kanë vizituar trajnime kryesisht mësimdhënësit e klasave të VII-ta për programet e reja. ● programet e akredituara të planifikuara në planin për ngritje profesionale të mësimdhënësve nuk janë realizuar deri në qeshor të vitit 2025.	X, XII, II, VI	Gzime Alili - drejtor Fatime Bexhei-Durmishi-arsimtar mentor dhe nëndrejtor.

Fusha e vlerësimit	Kriteret për sukses	Instrumentet	Indikatorët për sukses	Koha	Personi përgjegjës
Udhëheqja e portofolios profesionale	● portofoliot profesionale Përmbajnë punime të ndryshme dhe të kompletuara ● hulumtime	● protokoll për rishikim të portofolios profesionale ● procesverbale nga puna e aktiveve profesionale	● rritja e numrit të punimeve interne profesionale	X, XII, III, VI	Gzime Luma – drejtor Fatime Bexhei-Durmishi- arsimtar mentor dhe nëndrejtor.
Diseminim i kuadrit arsimor për INA	● realizimi i disminimit të kuadrit arsimor	● prezantimet ● listat e pjesëmarrjes ● procesverbalet nga mbajtja e përgaditjeve dhe diseminimi	● trajnimi i subjekteve në SHFK për MIO	X-XI	Senija Etemi - mësimdhënëse
Vetëevaluimi për INA	● E realizuar	● anketa për ● procesverbale ● raporte	● përcaktimi i anëve të dobëta/të forta të INA përcaktimi i pikave për ndryshim ● plani për aktivitete për INA	XI-XII	Gzime Luma - drejtor
Krijimi i partneritetit me shkollë tjetër	● realizimi i partneritetit me shkollë tjetër	● procesverbale ● formularë ● protokoll ● plane të veprimit	● realizimi i aktiviteteve sipas kritereve për INA	XI-XII	Senija Etemi - mësimdhënëse

Fusha e vlerësimit	Kriteret për sukses	Instrumentet	Indikatorët për sukses	Koha	Personi përgjegjës
Zvogëlimi i mungesave të paarsyeshme	● numri i mungesave të paarsyeshme është zvogëluar ● numër i zvogëluar i nxënësve të panotuar ● zvogëlim i numrit të këshillimeve për prindër me sukses të zvogëluar	● raporte të periudhave kualifikuese ● evidencë për rregullshmëri ● ditarët klasor ● anketa ● procesverbale nga këshillimet e prindërve për sukses të zvogëluar	● zvogëlimi i numrit të mungesave të paarsyeshme në periudhat kualifikuese ● analiza për rregullshmëri ● zvogëlimi i numrit të prindërve të dërguar në këshillime për mosvijim të rregullt të mësimit	XI, I, IV, VI	Medina Aliu - psikolog Leonora Ferati - mësimdhënëse
Punë me aktivet profesionale	● çdo anëtar ka realizuar nga një prezantim para aktivit profesional	● prezantimet e arsimtarëve - procesverbale nga aktivet profesionale ● portofolio profesionale	● rritja e numrit të shembujve për praktikë të mirë	XII, V	Kryetarët e aktiveve
Punë me bashkësinë e klasës	● sjellja e kodekseve të nxënësve dhe sjellja jo e dhunshme ● realizimi mbledhjeve	● anketa ● procesverbale nga mbledhjet ● punime të nxënësve ● panoa	● kodeks i nxënësve ● kodeks i nxënësve për sjellje jo të dhunshme ● realizimi i mbledhjeve	XII, V	Arsimtarët përgjegjës të aktiveve profesionale
“Shkollë pa dhunë“	● realizimi i punëtorive ● sjellja e kodeksit nxënësve për jo dhunë ● realizimi nga 2 orë nga për secilën klasë.	● planifikimi i punëtorive ● planifikimi i orëve për ОЖВ ● materiale ● anketa	● procesverbale nga punëtoritë ● punime të nxënësve ● planifikime ● zvogëlim i konflikteve ● interesimi i nxënësve	XI, IV, VI	Medina Aliu - psikolog

Fusha e vlerësimit	Kriteret për sukses	Instrumentet	Indikatorët për sukses	Koha	Personi përgjegjës
Udhëheqja e dokumentacionit pedagogjik	● udhëheqja e drejtë e- ditarit ● udhëheqja e drejtë e librave amë	● protokolle për rishikim në e-ditarin ● protokolle nga rishikimi në librat amë	● e-ditarin ● librat amë evaulimi	IX-VI	Gzime Luma – drejtor Fatime Bexhei-Durmishi-arsimtar mentor dhe nëndrejtor.
Realizimi i planprogramit vjetor	● realizimi i prioriteteve ● realizimi i detyrave ● realizimi i planeve të veprimit mbi 90%	● protokolle ● procesverbale ● analiza ● raporte ● formularë, shembuj, anketa	● e-ditarin ● librat amë evaulimi	IX-VI	Gzime Luma – drejtor Fatime Bexhei-Durmishi-arsimtar mentor dhe nëndrejtor

7. KALENDARI I VITIT SHKOLLOR 2024/2025 (180 ditë pune)

SHTATOR 2024						
H	M	M	E	P	SH	D
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	20 ditë pune					

TETOR 2024						
H	M	M	E	P	SH	D
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30	31			
21 ditë pune						

NËNTOR 2024						
H	M	M	E	P	SH	D
				1	2	3
4	5	6	7	8	9	10
11	12	13	14	15	16	17
18	19	20	21	22	23	24
25	26	27	28	29	30	
20 itë pune						

DHJETOR 2024						
H	M	M	E	P	SH	D
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	31	21 ditë pune				

JANAR 2025						
H	M	M	E	P	SH	D
		1	2	3	4	5
6	7	8	9	10	11	12
13	14	15	16	17	18	19
20	21	22	23	24	25	26
27	28	29	30	31		
10 ditë pune						

SHKURT 2025						
H	M	M	E	P	SH	D
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28		
20 ditë pune						

MARS 2025						
H	M	M	E	P	SH	D
					1	2
3	4	5	6	7	8	9
10	11	12	13	14	15	16
17	18	19	20	21	22	23
24	25	26	27	28	29	30
31	20 ditë pune					

PRILL 2025						
H	M	M	E	P	SH	D
	1	2	3	4	5	6
7	8	9	10	11	12	13
14	15	16	17	18	19	20
21	22	23	24	25	26	27
28	29	30				
21 ditë pune						

MAJ 2025						
H	M	M	E	P	SH	D
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	
21 ditë pune						

QESHOR 2025						
H	M	M	E	P	SH	D
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	29
30	6 ditë pune					

Festat për vitin shkollor 2024 - 2025	
8 shtator, e djel (e hënë ditë jo pune)	Dita e pavarsis së RMV
11 tetor, e premte (ditë jo pune)	Dita e kryengritjes së RMV
23 tetor, e mërkurë (ditë jo pune)	Dita e Luftës Revulucionare e RMV
22 nëntor, e premte (ditë jo pune)	Dita e alfabetit shqip
8 dhjetor, e diel (e hënë ditë jo pune)	Dita e Shën "Klimenti i Ohrit"
1.01.2025 – 19.01.2025 (ditë jo pune)	Pushimi dimëror
30 mars, e diel (e hënë ditë jo pune)	Dita e Fitër Bajramit
21 prill, e hënë (ditë jo pune)	Dita e Pashkëve
1 maj, e enjte (ditë jo pune)	Dita Ndërkombëtare e Punonjësve
24 maj, e shtunë (ditë jo pune)	Dita e arsimit - Shën Kirili dhe Metodi
25 maj, e diel (e hënë ditë pune)	Dita e Patronatit të shkollës
6 qeshor, e premte (ditë jo pune)	Dita e Kurban Bajramit

Struktura globale e punës edukativo-arsimore

Mësimi obligativ	
Aktivitetet edukativo arsimore jashtëmësimore	● Aktivitetet e lira të nxënësve. ● Ekskursionet e nxënësve. ● Garat dhe vizitat e nxënësve në kompanitë prodhuese lokale. ● Puna prodhuese dhe shërbimi i komunitetit të nxënësve. ● Kujdesi i shkollës për shëndetin e nxënësve. ● Mbrojtja nga zjarret, tërmetet dhe fatkeqësive tjera.
Angazhimi kulturoro arsimor i shkollës në mesin lokal	● Bashkëpunimi me familjen. ● Bashkëpunimi me institucionet edukativo arsimore, ● Institucionet dhe organizatat nga lëmi e kulturës, ekonomisë etj. ● Organizimi i aktiviteteve të ndryshme shoqërore, kulturore me banorët lokal. ● Informimi i nxënësve dhe opinionit të gjerë për punën dhe rezultatet e nxënësve.
Përcjellja, avancimi dhe vlerësimi i punës edukativo arsimore	● Programi punës së drejtorit për udhëheqje pedagogjike të procesit edukativo arsimor në shkollë. ● Programi i punës së nëndrejtorit për udhëheqje pedagogjike të procesit edukativo arsimor në shkollë. ● Programi i punës së pedagogut të shkollës. ● Programi i punës së psikologut të shkollës. ● Programi i punës së edukatorit special dhe rehabilitues. ● Programi i punës së sociologut. ● Programi i punës së bibliotekistit të shkollës. ● Plan dhe program për punë të këshillit të arsimtarëve. ● Plan dhe program për punë të këshillave klasor. ● Plan dhe program për punë të aktiveve profesionale të shkollës.

8. Mësimi

8.1. Lloji i mësimit

Procesi mësimor është zhvilluar sipas Planit dhe Programit të Ministrisë për arsim dhe shkencë të RMV, Byrosë për zhvillim të arsimit të RMV, Planet dhe programet e shkollës në gjuhën shqipe.
Udhëheqës: gjithë arsimtarët veçanërisht, arsimtarë përgjegjës të aktiveve profesionale, shërbimi profesional, drejtori dhe nëndrejtori.
Sipas planit mësimor në shkollë u organizua dhe realizua:

1. mësimi obligues
2. mësimi zgjedhor
3. mësimi plotësues
4. mësimi shtues
5. mësimi vazhdues

Gjatë gjithë vitit shkollor u realizuan: Programi „Integrim i edukimit ekologjik në sistemin arsimor të RMV-së. Leximi ju bën udhëheqës (USAID).

Shkolla jonë posedon kuadër të përshtatshëm, i cili i plotëson të gjitha kualifikimet e nevojshme, ku mbisundon potenciali i lartë arsimor dhe profesional.

8.2. Organizimi i mësimit

Në SHFK "Naim Frashëri" mësimi zhvillohet në hapësira mësimore klasa të cilat janë me normativ, të përshtatshme për atë qëllim.
Shkolla posedon hapësirat mësimore të cilat vijojnë:

Hapësirat mësimore në SHFK **"**Naim Frashëri**"** – Tetovë

- 32 klasa klasike, nga të cilat 2 të pajisura me kompjuterë;
- Sallë të arsimit fizik dhe shëndetësor nuk ka.

Sipas kushteve të hapësirave, organizohet mësim në dy ndërrime.
Në ndërrimin e parë organizohet mësim për nxënësit nga klasa VI – IX, kurse në ndërrimin e dytë organizohet mësim për nxënësit nga klasa I - V të mësimit klasor.
Ora mësimore zgjat 40 minuta. Koha mësimore në ndërrimin e parë fillon më 07:30 ndërsa ndërrimi dytë në ora 13:30.

Orari i kohës mësimore është dhënë siç vijon:

Ndërrimi i parë SHFK "Naim Frashëri"		Ndërrimi i dytë SHFK "Naim Frashëri"	
Ora	**kohëzgjatja**	**Ora**	**kohëzgjatja**
1	**07:30 – 08:10**	**1**	**13:30 – 14:10**
2	**08:15 – 08:55**	**2**	**14:15 – 14:55**
3	**09:00 – 09:40**	**3**	**15:15 – 15:55**
4	**10:00 – 10:40**	**4**	**16:00 – 16:40**
5	**10:45 - 11:25**	**5**	**16:45 - 16:25**
6	**11:15 - 11:55**	**6**	**16:30 – 17:10**
7	**11:55 –12:35**	**7**	**17:15 – 17:55**

Lëndët obliguese të cilat mësohen në SHFK "Naim Frashëri", realizohen në pajtim me Planin dhe programin e paraparë nga MASH dhe BZHA.

Gjuhë e huaj e parë e cila mësohet në shkollë është gjuha angleze. Si gjuhë e dytë e huaj nxënësit nga klasa VI-IX e mësojnë gjuhën frenge dhe ate gjermane.

Mësimin në shkollë e realizojnë arsimtarë me kualifikime profesionale të përshtatshme në gjithsej 61 paralele. Me paralelet, sipas ligjit, udhëheqin kujdestar të paraleles.

Udhëheqësi i paraleles, e realizon programin për orë të bashkësisë së klasës, analizon rezultatet edukativo arsimore, kujdeset për zgjedhjen e problemeve edukativo arsimore të nxënësve të ndryshëm, bashkëpunon me prindërit dhe stafin profesional të shkollës, propozon dhe vendos për masat edukative dhe kryen detyra tjera të parapara me statutin e shkollës.

Të gjithë kujdestarët e klasave, përveç atyre të klasës së parë, realizojnë orë nga bashkësia e klasës edhe atë me nga 1 orë në javë, në fakt 36 orë në vit. Në këto orë realizohet program i veçantë për arsimim të aftësive jetësore, e cila ka për qëllim të kontribuon për zhvillimin personal dhe shoqëror të nxënësve dhe në atë mënyrë të ndihmohen në zhvillim të aftësive psikosociale, duke i aftësuar nxënësit për sfidat e jetës së përditshme. Aftësitë psikosociale kanë rëndësi të madhe në promovimin e shëndetit në përgjithësi – sigurimin e mirëqenies së tyre fizike, mendore dhe shoqërore.

Ora e bashkësisë së klasës është obligueshme. Për nxënësit e klasës së parë pjesë e programit realizohet në orët në të cilat realizohen programet mësimore.

Kujdestari klasës ka përcjell të arriturat e nxënësve të paraleles, bashkëpunuar me arsimtarët, prindërit, stafin profesional, drejtorin e shkollës dhe tjerë subjekt të cilët janë në të interesuar për suksesin dhe zhvillimin e përgjithshëm të nxënësve.

Me rregull ka udhëheq evidencën dhe dokumentacionin e paraleles. Kujdestari i klasës me propozim të drejtorit e zgjedh këshillin arsimor të shkollës. Si udhëheqës pedagogjik, organizativ dhe administrativ puna e kujdestarit të klasës është e fokusuar në:

- Angazhim rreth përmirësimit të suksesit të nxënësve;
- Bashkëpunim me prindërit e nxënësve;

- Veprim edukativ dhe edukim;
- Detektim i problemeve dhe preventiva e tyre;
- Përmirësimi i standardit të nxënësve;
- Udhëheqja e dokumentacionit pedagogjik;
- Rregullimi estetik i hapësirës për punë dhe mësim.

Kujdestarët e klasave kanë punuar sipas planit të përgatitur për vitin shkollor me sa vijon:

- Realizimi i programit për aftësi jetësore
- Realizuan orë klase ku u rishikuan problemet edukativo-arsimore dhe probleme tjera,
- Dhan lëvdata, praktikuan masa edukative-pedagogjike ndaj nxënësve dhe propozuan në këshillin e arsimtarëve për çmime ose masa të ndryshme pedagogjike,
- Realizuan mbledhje prindërore.

Organizuan bashkëpunime të ndryshme me prindërit e nxënësve dhe me vetë nxënësit.

8.3. Mësimi zgjedhor

Lëndët zgjedhore japin mundësi nxënësve që t`i zgjerojnë dhe thellojnë dituritë nga lëndë mësimore të ndryshme dhe ti zhvillojnë aftësitë e tyre. Bëhet fjalë për secilin nxënës, kurse qëllimi përbëhet në atë se secili nxënës kryen zgjedhje të lëndëve të cilat do ti mësojë në varësi të nevojave dhe interesit të tij. Mënyra e zgjedhjes së lëndëve është paraparë në pajtim me Ligjin për arsim fillor, kurse lëndët e ofruara janë në pajtim me planin mësimor të BZHA për klasën e paraparë. Zgjedhja bëhet me anketimin e prindërve në fund të vitit të kaluar shkollor. Në tabelën në vijim janë dhënë lëndët e propozuara dhe të pranuara zgjedhore të vitit shkollor **2024/2025.**

- Mësimi zgjedhor në këtë vit shkollor është zgjedhur në këto lëndë dhe paralele.

Lëndë zgjedhore

Lënda e lirë zgjedhore - aktivitet e lira zgjedhor	Klasat	Nrumri i orëve javore	Nrumri i orëve vjetore
Lëndë të lira zgjedhore (Aktivitete të lira)	I - 1, 2, 3, 4, 5, 6 II - 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 III - 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7	2 2 2	72 72 72
Lëndë të lira zgjedhore Origami dhe vizatim	IV - 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7	2	72
Lëndë të lira zgjedhore Futbolli dhe vallzimi	V - 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7	2	72
Religjioni botëror Filozofia për fëmijë	VI - 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 VI - 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7	2 2	36 36
Valle dhe vallëzim Sport zgjedhor Arsim teknik dhe informatik Aftësi për jetes	VII - 3 VII - 5 VII - 1, 2, 4 VII - 6	2 2 6 2	36 36 36 36
Projekte nga informatika	VIII - 1, 2, 3, 4, 5, 6	2	72
Programim Avancim shëndeti	IX – 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 IX – 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7	2 2	36 36
Korri i shkollës, orkestri i shkollës		3+3	

Mësimi plotësues

Mësimi plotësues, në përputhje me ligjin për arsim fillor është organizuar për nxënësit të cilët në vazhdimësi tregojnë rezultate të dobëta në mësim, veçanërisht nëse:

- kanë pasur së paku dy nota të dobëta,
- kanë rezultate të dobëta në lëndë mësimore të caktuara
- mungojnë nga mësimi në lëndë të caktuar dhe
- në kërkesë të nxënësit apo prindit të tij, apo kujdestarit.

Arsimtari i cili e realizon mësimin në lëndën mësimore i obligon nxënësit me nota të dobëta të vijojn mësim plotësues.

Për nxënësit të cilët mungojnë nga lëndë e caktuar mësimore ose në rast se prindi i tij, apo kujdestari i tij kërkon të realizohet mësimi plotësues, arsimtari vepron sipas vlerësimit të tij.

Nxënësi i udhëzuar në mësim plotësues në periudhën e një muaji viziton mësim plotësues më së shumti në dy lëndë mësimore me më së shumti katër orë të mësimit lëndor.

Nëse nxënësi nuk i përcjell orët e mësimit plotësues merr mungesë të paarsyeshme. Për udhëzimin e nxënësit në mësim plotësues, arsimtari me kohë lajmëron prindin, në fakt kujdestarin e tij.

Arsimtarët realizuan mësimin plotësues me program të përshtatshme paraprakisht të përgatitur. Në program planifikohen së paku 36 orë mësimore në vit. Fondi i përgjithshëm i orëve plotësuese i cili një arsimtar i realizon në nivel vjetor në gjitha paralelet ku realizohet mësim i rregullt dhe zgjedhor, është 72 orë mësimore.

Orari për realizimin e mësimit plotësues përgatitet në përputhje me orarin e mësimit të rregullt, më së voni gjer 20 shtator të vitit shkollor me interes të nxënësve.

Çdo arsimtar është i detyruar ta paraqes listën e nxënësve të cilët do të vijojnë mësim plotësues më së voni të premten e javës së kaluar të punës, në vend të dukshëm në klasë apo në korridorin e shkollës.

Për organizim të suksesshëm të mësimit plotësues patjetër është përcjellja e përgjithshme dhe kontinuitive dhe vlerësimi i suksesit dhe përparimit të secilit nxënës, si dhe vendosja e pikës dhe diagostifikim saktë i nevojave të tij zhvillimore kërkesat, arriturat, mungesat etj.

Stafi profesional në mënyrë aktive merr pjesë në mësimin plotësues me qëllim të detektimit të arsyeve të suksesit të dobët të secilit nxënës veç e veç, prej nga dalin masa më të përshtatshme për përmirësimin e suksesit të dobët si negativitet.

Mësimi shtues

Mësimi shtues organizohet për nxënësit të cilët arrijnë rezultate të dalluara në lëndë të ndryshme (nxënës të talentuar). Arsimtari është i obliguar t'ua ofrojë mësimin shtues këtyre nxënësve, ndërsa nxënësit vendosin vet se a do ta përcjellin atë. Arsimtari është i obliguar tu ofrojë program të përgatitur paraprakisht, si zgjerim i përshtatshëm i mësimit të rregullt e cila realizohet në klasën e dhënë. Programi për mësim shtues planifikohet së paku 36 orë në vit.

Orari për realizimin e mësimit shtues përpunohet në përputhje me orarin e mësimit të rregullt, më së voni gjer më 20 shtator të vitit shkollor në vijim dhe është në interes të nxënësve.

Lloje tjera të mësimit

Nxënësi i cili në fund të vitit shkollor në klasën e gjashtë, shtatë, tetë dhe nëntë ka notë të dobët në më së shumti dy lëndë mësimore dërgohet në provim përmirësues. Për këta nxënës shkolla fillore është e obliguar të organizojë mësim vazhdues në qershor. Realizimi i këtij mësimi në vitin shkollor 2024/2025 është paraparë në periudhën prej 16.06.2025 deri më 27.06. 2025.

Nxënësi i cili pas vijimit të mësimit vazhdues nuk tregon sukses pozitiv, dërgohet në provim. Provimet nxënësi i merr në qershor dhe gusht, terminin e cakton komisioni i formuar i provimit në pajtim të drejtorit. Nxënësi i cili nuk do ta jep provimin në një ose dy lëndë mësimore mbahet në të njëjtë klasë.

Në bazë të programeve të Projektuara, kushtet për punë dhe metodologjinë e definuar dhe organizimin e mësimit presim niveli i punës mësimore të rritet në nivel më të lartë.

Përparim të veçantë presim në drejtim të komponentit edukativ dhe punës edukativo arsimore.

Në pajtim me Koncepcionin e edukimit dhe arsimimit fillor është kërkuar në shkollë të realizohet edhe program i zgjeruar për qëndrim i vazhduar i nxënësve. Programi i zgjeruar përfshin pranim dhe mbrojtje të nxënësve nga klasa I, II dhe III para fillimit të orëve të mësimit të rregullt dhe një orë pas përfundimit të mësimit të rregullt, në pajtim me prindërit.

Gjatë qëndrimit të vazhduar nxënësit mësojnë, punojnë detyrat e shtëpisë, punojnë detyra tjera shkollore dhe marrin pjesë në aktivitete kulturor- artistike, sportive dhe aktivitete tjera sipas programit për punë.

Në pajtim me Ligjin për mësim fillor, për arsimtarët në arsimin fillor fondi javor i orëve mësimore ishte si vijon:

- për arsimtarin klasor nga 20 deri 23 orë mësimore në të cilat hynë edhe koha për pranim të organizuar të nxënësve para dhe pas mësimit, kurse nuk hynë orët për mësim shtues dhe plotësues;
- për arsimtarin lëndor është 20 deri 23 orë, në cilën nuk bëjnë pjesë orët nga mësimi plotësues dhe shtues. Gjithashtu në këtë fond nuk hyjnë orët ku realizohen programet e seksioneve shkollore.

9. Aktivitete jashtëmësimore

Kjo fushë përfshin përmbajtje dhe aktivitete që janë kryer jashtë mësimit.

Nëpërmjet kësaj fushe nxënësve ju dha mundësia për të zhvilluar një jetë aktive, duke rritur interesat dhe aftësitë dhe duke ndërtuar ndjenjë morale, kulturore, ndjenjë estetike dhe dëshirë për zhvillimin e shpejtë fizik dhe intelektual. Kjo është një fushë ku para nxënësve vihet jeta e vërtetë që pas mbarimit të shkollës fillore do të angazhohet në mënyrë aktive.

Në shkollën tonë nga kjo fushë janë organizuar këto aktivitete:

Aktivitete edukativo arsimore jashtëmësimore	Sporti shkollor Seksione dhe të aktiviteteve të lira të nxënësve Gara të nxënësve Eko - Patrulla Punë shoqërore humanitare

Sporti shkollor

Për zhvillimin e sportit shkollor kontribut të veçantë dha klubi sportiv i shkollës që ka ndërmarrë një sërë aktivitetesh në vitin shkollor 2024/2025. Janë përfshirë një numër i madh i nxënësve nga shkolla, që kishin mundësi për të konkurruar si në shkollë ashtu edhe në gara rajonale dhe të qytetit.

Në fillim të vitit shkollor nxënësve u është ofruar për të zgjedhur sportin ku duan të marrin pjesë. Nëpërmjet seksioneve janë stërvitur dhe mësuar teknikat specifike dhe taktikat që mund të zbatohen në lojërat që pasojnë. Duke organizuar gara të shkollës, bëhet përzgjedhja e nxënësve që tregojnë aftësi më të mira në lojë si në planin teknik-taktik dhe psikologjik. Me ekip tashmë të themeluar të shkollës do të konkurrojmë konkurse rajonale dhe më gjërë.

SHFK “Naim Frashëri” merr pjesë aktive në të gjitha garat e planifikuara të organizuara nga Lidhja Komunale e sportit shkollor në Tetovë. Objektivat e sportit shkollor në këtë vit shkollor janë që nëpër sportet e ndryshme të ofruara për nxënësit në masë dhe në mënyrë aktive të marrin pjesë në sport në garat shkollore dhe në këtë

mënyrë të përqendrohen në një sport të caktuar, më tej socializimi dhe respekti ndëretnik me nxënësit e e kombësive të tjera, raport fer- play, ndërtimi i një avantazhi konkurrues dhe formimi i një person të fortë dhe të shëndetshëm.

Të dhëna të aktiviteteve të planifikuara të cilat janë realizuar në vitin shkollor 2024/2025.

Lloji i sportit	Koha e realizimit	Sistemi i garave	Gjinia	Lloji i garave	Mësimdhënësi përgjegjës
Futboll	Tetor – Maj	Liga	Mashkullore	Komunale	Izedin Murati
Basketboll	Tetor – Maj	Liga	Mashkullore	Komunale	Vjollca Islami
Futboll	Shkurt	Turne	Femërore	Komunale	Altrim Memedi
Basketboll	Mars	Turne	Femërore	Komunale	Betim Haziri
Volejboll	Shkurt	Turne	Femërore	Komunale	Veton Murati
Hendboll	Mars	Turne	Femërore	Komunale	Lutfi Vejseli
Ping – Pong	Prill	Turne	Femërore	Komunale	Albi Ajredini
					Altina Ademi

Seksionet dhe aktivitete e lira të nxënësve

Aktivitetet e lira të nxënësve kanë për qëllim që të plotësojnë dhe të nxisin interesat dhe aftësitë e nxënësve individuale për të zhvilluar pavarësinë, qëndrueshmërinë, këmbëngulësinë dhe krijimin e shprehive për përdorimin e duhur të kohës së lirë. Në veprimtaritë e lira të nxënësve marrin pjesë ata nxënës që kanë preferenca dhe interesa, pavarësisht suksesit në mësimdhënie. Interesi personal i nxënësit ka rëndësi primare në përcaktimin e llojit të aktiviteteve të lira.

Aktivitetet e lira të nxënësve janë ndarë në grupe edhe atë:

- ✓ Aktivitetet e lira për zgjerimin e diturive sipas lëndëve të caktuara;
- ✓ Aktivitetet e lira teknike;
- ✓ Aktivitetet e lira punuese – prodhuese;
- ✓ Aktivitetet e lira sportive.

Aktivitetet e lira kulturore-artistike;

Në aktivitete e lira kulturore i dallojmë korin e shkollës dhe orkestrin që menaxhohet nga mësimdhënësja e artit muzikor **Laureta Fetahi dhe Elif Elmazi.** Kori numëron 25 nxënës, në varësi të brezave që përfundojnë dhe përfshin vetëm nxënës nga klasat e larta. Instrumenti i përdorur nga orkestra e shkollës është një bllok-flaut. Është përbërë nga nxënës të klasës së gjashtë dhe të shtatë 25 anëtarë, në varësi të brezit. Sipas programit mësimor të BZHA, kori dhe orkestra përfaqësohen me nga tri orë në javë.

Në shkollën tonë në vitin shkollor 2024/2025 nxënësve u janë ofruar një numër i madh i seksioneve, sipas ligjit, është në mënyrë vullnetare.

Garat e nxënësve

Shkolla e në vazhdimësi investon në zhvillimin e saj dhe krijon klimë pozitive, produktive dhe stimuluese dhe krijon nxënës të cilët do të japin maksimumin e tyre për realizimin e afiniteteve dhe aftësive të tyre personale. Shfrytëzimi i drejtë i energjisë të cilën e bartë në vete nxënësi dhe mundësia për të arritur

më shumë dituri sipas afinitetit është detyrë e shkollës, e cila e udhëheq nxënësin kah arritja e sukseseve më të mëdha. Çdo nxënës mburret me të arriturat e tij, si dhe të arriturat që i bart në emër të shkollës. Çelësi i suksesit qëndron tek të gjithë ne të cilët i inkurajojmë me motivet që nxënësitë tregon vetveten dhe dëshira për afirmimin e shoqërisë. Për këtë qëllim nxënësit e shkollës sonë në vazhdimësi janë pjesëmarrës në garat e lëmive të ndryshme dhe niveleve të ndryshme. Mënyra e organizimit të garave dhe realizimit, nxënësit në lëndë të ndryshme në garat komunale, regjionale dhe shtetërore i parashikon Ministri, në bashkëpunim me BZHA-në.

Gjatë organizimit dhe pjesëmarrjes në gara në shkollë janë respektuar rregullat të cilat janë të dhëna për këtë qëllim.

- ✓ Shërbimi i shkollës në kohë ka paraqitur planin në tabelën e buletinit sipas të cilit do të realizohen dhe mbahen garat shkollore.
- ✓ Garat shkollore i ka organizuar një ekip prej më së paku 3 arsimtarëve, prej të cilëve njëri është zgjedhur si përgjegjës me programin vjetor të shkollës.
- ✓ Dy ditë para se të mbahen garat nga lënda e paraparë vijon lajmërimi i cili do të lexohet në të gjitha paralelet dhe do të përmban informatë të kompletuar dhe me kohë për nxënësit.
- ✓ Rezultatet nga gara e realizuar përgjegjësit duhet të i paraqet në tabelën e buletinit më së voni një javë pas mbajtjes së garës.
- ✓ Informatë gojore për rezultatet e arritura janë prezantua para të gjithë pjesëmarrësve në garë.
- ✓ Ekipi kanë të përgatitur një poces verbal nga gara e realizuar shkollore dhe raport për rezultatet.
- ✓ Nxënësi ka drejtë të paraqitet apo të merr pjesë në më së shumti dy gara shkollore, apo vetëm në dy lëndë mësimore.
- ✓ Në qoftë se një nxënës fiton vendin e parë në dy gara, atëherë mund të merr pjesë në dy garat komunale, regjionale, shtetërore vetëm me vet dëshirë dhe nëse ekziston dallim i duhur kohor mes terminëve në më së paku një javë.
- ✓ Në garat komunale, regjionale, shtetërore mund të merr pjesë edhe garuesi i cili ka marrë vendin e dytë nëse i pari abstenon.
- ✓ Nxënësi me rregull i viziton orët përgaditore të organizuara nga ana e arsimtarit-mentorit dhe të kryen detyrat e dhëna.
- ✓ Nxënësi dhe mentori të mundohen për një bashkëpunim sa më të madh dhe përgaditje për garat që pasojnë.
- ✓ Mentori në kohë i ka paraqitur materialet nga të cilat do të përfitohen dituri plotësuese nga disiplina e përshtatshme.

Për realizimin e garave janë respektuar regullat që pasojnë:

- ✦ Është përgatitur lista e nxënësve pjesëmarrës në garë.
- ✦ Është zgjidh komisioni nga arsimtarët përkatës.
- ✦ Komisioni ka përgatit test për realizimin e garave shkollore.
- ✦ Testi të jetë i standardizuar me detyra të nivelit më të lartë të diturive.
- ✦ Është përcaktuar koha, vendi dhe mënyra e realizimit të garës shkollore.
- ✦ Dy ditë para garës së paraparë të lexohet lajmërimi në të gjitha paralelet.
- ✦ Respektimi i kornizës së paraparë kohore të planit.
- ✦ Realizimi i garës në një atmosferë jashtëzakonisht të qetë me kornizë kohore më parë të vërtetuar.
- ✦ Pjesëmarrja e komisionit në garë.

Për deri sa mentori e përgatit nxënësin për garë në rang më të lartë, atëherë kemi pasur kujdes siç vijon:

- Arsimtari-mentori nëpërmjet mësimit plotësues ei ka përgatit nxënësin rregullisht.
- Arsimtari-mentori rregullisht ka qenë në dispozicion në mbështetje të nxënësve në përgatitjen e mësimeve.
- Është formuar një ekip nga arsimtar përgjegjës të cilët kanë për detyrë të kontrollojnë rregullshmërinë në kryerjen e detyrave në drejtim të përgatitjes së garave që pasojnë.
- Është hapur një fashikull për çdo lëndë mësimore në të cilat do të shënohen aktivitetet, prezenca, fletorja dhe materialet me të cilat do të realizohen ushtrimet përgatitore.
- Fashikulli është në dispozicion të shërbimit profesional dhe drejtorit, nëse dëshirojnë ti shohin.

Në përgatitjet përfshihen materiale jashtë programeve mësimore.

ajmërimi me kohë dhe mirëkuptimi për pjesëmarrjen e nxënësve tjerë dhe arsimtarëve.

Këshilli arsimor apo bashkësia e klasës mund të propozojnë ndryshime të këtyre rregullave. Për ndryshimet vendoset me koncesuz të plotë dhe në përputhje me rregullativën ligjore dhe dokumente të ngjashme që janë në fuqi.

Në kornizën e mundësive dhe në pajtim me rregullativën për shpërblimin e nxënësve, shkolla mundësoj shpërblime simbolike tablet dhe mirënjohje për nxënësit më të mirë.

Kalendari për garat e realizuara në vitin shkollor 2024/2025.

Lënda/ lëmia garuese	Arsimtari përgjegjës	Klasa	Gara shkollore	Gara komunale	Gara regjionale	Gara shtetërore	Gara ndërshtetërore
Arsim fiz. dhe shën-not	Veton Murati	VI		Nxënësi: Rinor Beqiri Vendi i parë			
Arsim fiz. dhe shën-not	Lutfi Vejseli	V		Nxënësi: Erdi Shabani Vendi i dytë			
Arsim fiz. dhe shën-not	Lutfi Vejseli	V		Nxënësi: Luna Sahiti Vendi i dytë			
Arsim fiz. dhe shën-not	Xhemal Dehari	VI		Nxënësi: Njomza Vejseli Vendi i dytë			
Arsim fiz. dhe shën-not	Mentori: Lutfi Vejseli	V		Nxënësi: Stina Hajruli Vendi i tretë			
Arsim figurativ	Arbina Bexheti	VI				Nxënësi: Veton Muaremi Vendi i parë	
Arsim fiz. dhe shën- volejboll	Altrim Memedi Xhemal Dehari	IX-ta		Nxënësi: Grup i nxënësve Vendi i parë			
Gjuhë angleze	Ramije Kurtishi	VIII			Nxënësi: Zara Memeti Spelling Bee Competition Vendi i parë		

Gjuhë angleze	Ramije Kurtishi	VIII			Nxënësi: Azra Idrizi Spelling Bee Competition Vendi i tretë		
Gjuhë angleze	Viola Luma	VII			Nxënësi: Amelia Skenderi Spelling Bee Competition Vendi i dytë		
Gjuhë angleze	Leonora Ferati	VI			Nxënësi: Dea Ajruli Spelling Bee Competition Vendi i tretë		
Kimi	Hanife Ahmeti	VIII	Nxënësi: Lorenza Memedi Vendi i parë				
Gjuhë maqedone	Afrdita Cami	IV	Nxënësi: Jon Lika Vendi i parë				
Gjuhë maqedone	Afrdita Cami	IV	Nxënësi: Trim Emini Vendi i parë				
Gjuhë angleze	Blerim Kamberi	IV	Nxënësi: Amar Ibrahimi Vendi i parë				

Puna humanitare-shoqërore

Puna prodhuese shoqërore dhe shfrytëzuese në shkollë është realizuar aktivitet me program paraprak të përgatitur. Në këtë aktivitet janë të kyçur të gjithë nxënësit dhe të punësuarit e shkollës. Qëllimi i bashkëngjitjes së shkollës në punët prodhuese dhe punët në dobi të shoqërisë është që të zhvillohet dashuri ndaj punës dhe marrëdhënie pozitive në punë, respekt ndaj njeriut punëtor, mjetet për prodhim si dhe rezultatet nga mundi.

Aktivitet të planifikuara	Koha e realizimit	Realizues	Forma	Për kë ose para kujt është realizuar	Efektet e pritura dhe rezultatet
Mirëmbajtja dhe kujdesi i ndërtesës shkollore dhe oborrit. Fillimi i vitit të ri shkollor. Përgaditje dhe punimi i zbukurimeve të Vitit të Ri. Patronati.	IX, XII, IV,VI	Mësimdhënës -nxënës	Grupore	Nxënësit, prindërit dhe të ftuar të tjerë	Njohuri themelore të punës të organizuar
Mirëmbajtja dhe kujdesi për rrethin ambientin jetësor (shkollë, komunë).	Në vazhdimësi	Mësimdhënës -nxënës	Grupore	Nxënësit	Zhvillimi i dashurisë dhe zakonet pozitive për të ruajturmjedis të pastër dhe të shëndetshme
Organizimi i akcioneve për mbledhjen e bimëve shëruese (në ekskurzion). Mbledhja e mbeturinave dhe letra të vjetra dhe plastik. Mbledhja e librave dhe materijale tjera shfrytëzuese.	IX, X,V	Mësimdhënës -nxënës	Grupore	Nxënësit	Dashuria dhe qëndrim pozitiv për punën dhe mundin, zhvillimi i humanitetit dhe dhe të zhvillohet një qëndrim pozitiv ndaj miqve të tyre
Mbjellja dhe rregullimi i oborrittë shkollës Rregullimi i oborrit me mbjelljen e luleve dhe drunjëve.	IX, XII, III, V	Mësimdhënës -nxënës	Grupore	Nxënësit	Aftësia për të punuar me mjete, dashuri për stinët e vitit
Mbjellja e luleve dhe drunjëve për rastin e ditës së drurit.	III	Mësimdhënës -nxënës	Grupore	Nxënësit	Fitimi i njohurive të botanikës
Kujdesi dhe rruajtja e luleve.	Në vazhdimësi sipas nevojës	Mësimdhënës -nxënës	Grupore	Nxënësit, prindërit dhe të ftuar të tjerë	Kujdes dhe dashuri ndaj luleve

10. Mbështetja e nxënësve

Klima pozitive socio-emocionale

Në proçesin mësimor nuk janë të vlefshme vetëm të arriturat e nxënësve, por edhe arritja e përvojës e cila do të i ndihmojë në funksionomon e mëtutjeshëm të nxënësit në shoqërinë demokratike. Për atë realizimi e qëllimeve të proçesit edukativo –arsimor në shkollë në masë të madhe mvaret nga klima socio-emocionale e cila gjendet në shkollë.

Në kreativitetin e klimës pozitive në shkollën tonë ndikojnë shumë faktorë, të cilët mes veti janë ngushtë të ndërlidhura dhe të ndërthurura. Një pjesë e tyre janë relativisht objektive dhe më vështirë mund të ndryshohen, si p.sh. madhësia e vendit ku gjendet objekti i shkollës, largësia e shkollave tjera, numri i nxënësve në klasë, struktura sociodemografike e nxënësve etj. Të tjerat janë subjektive dhe në to mund të ndikohet,dhe me vet atë mund të ndryshohet klima në shkollë dhe në klasë. Mes të gjithë këtyre faktorëve rol kryesor ka arsimtari me mënyrën e tij të udhëheqjes, me karakteristikat e tij personale dhe me profesionin e tij. Klima pozitive kontribuon në angazhimin edhe më të madh të arsimtarit në realizimit e procesit edukativo- arsimor dhe qëllimet e parapara, të arritura më të mëdha shkollore, qëndrime pozitive të nxënësve kundrejt arsimtarit dhe shkollës, si dhe marrëdhënie më të mira ndërpersonale.

Në përgjithësi, duke punuar në krijimin e një klime socio-emocionale në shkollën tonë jemi të orientuar kah qëllimi që njëkohësisht të ketë kujdes për emocionalitetin dhe dukuritë sociale të nxënësve. Zhvillimi i sjelljes së mirë në klasë mvaret nga aftësitë e arsimtarit, dhe duhet që të i plotësojë kërkesat e nxënësve. Vëmendje të posatshme i kushtohet një grupi të detektuar të nxënësve, ku arsimtarët tanë udhëhiqen sipas parimeve që vijojnë:

- Arsimtari është i përgatitur ti dëgjojë nxënësit.
- Arsimtari është i përgatitur tu përgjigjet sugjestioneve të tyre.
- Arsimtari është i përgatitur ti pranojë dhe kuptojë ndjenjat e tyre.
- Arsimtari është i përgatitur që ti kyç në procesin mësimor dhe të i inkurajon gjatë punës.

Këto komponentë që janë pjesë e marrëdhënieve ndërpersonale të cilat ekzistojnë në klasë japin mundësinë që të ekziston liria e komunikimit, të merr pjesë aktive gjatë marrjes së vendimeve, stimulon udhëheqjen e klasës, fleksibilitet etj. Me këto mënyra kemi sukses në krijimin e kushteve dha atmosferës së duhur, dhe krijojmë klimë pozitive emocionale dhe të përmbajtur në klasë.

Shërbimi profesional i shkollës është përgjegjës për planifikimin dhe udhëheqjen e aktiviteteve në këtë pikëpamje, dhe të njëjtat janë të parapara në programin vjetor për punën e psikologut të shkollës.

Programe individuale me nxënës te talentuar

Një nga sfidat kryesore në ndryshimin e paradigmës së mësimdhënies dhe të mësuarit tradicional ishte çështja e mësimit të individualizuar.

Edukimi duhet të plotësoj kërkesat e të gjithë nxënësve, stilet e tyre të të mësuarit, metodat, interesat dhe talentet.

Fakti është se kategoria e fëmijëve të talentuar të kërkojë më shumë personifikim, më shumë vëmendje për të zhvilluar aftësitë e tyre. Programet e ndihmës për studentë të talentuar në të kaluarën ishin të bazuar në idenë tu ofrohet më shumë informacione, më shumë materiale dhe ndoshta më shumë aktiviteteve në mënyrë që të sigurohet se ata në këtë mënyrë do të fitojnë më shumë njohuri. Sot këtyre studentëve i afrohemi ne menyrë më të organizuar dhe nga aspekte te ndryshme.

Në shumë vende të botës, edhe këtu, nxënësve të talentuar, sipas ligjit i ofrohen nga opsionet fleksibile arsimore, si që janë:

- Regjistrimit para kohë
- Kapërcim të viteve shkollore
- Puna me programe të avancuara mësimore;
- Mundësohen përmirësime të vazhdueshme në klasat e tyre të rregullta;
- Regjistrim paralel në klasat më të larta apo klasa të avancuara
- Kalim i provimeve.

Duke punuar me nxënës të talentuar përgatitet program pune të individualizuar në shkollë, me të cilën planifikohe zhvillimi i këtij nxënësi dhe përparimin e tij në mësim, duke marrë parasysh aspektet psikologjike, pedagogjike dhe ekonomike. Pasi nxënësi do të njihet nga mësuesit si një nxënës i talentuar, vazhdohet me një proces të identifikimit ose matjen e nivelit të talentit nga shërbimi psikologjik - pedagogjik, për të cilën ekzistojnë protokolle specifike. I tërë procesi zhvillohet në bashkëpunim me prindi ose kujdestari i nxënësit.

Shërbimi profesional në "Naim Frashëri" vijon talentet e nxënësve në fushat e mëposhtme:

Lloj i talenteve të nxënësve		Gjithsej nxënës
Shprehje gjuhësore	Shprehje me goje - oratore	20
	Shprehje me shkrim	17
	Shprehje e kombinuar	18
Matematikë		12
Arti figurativ		20
Arti muzikor		24
Aktivitete sportive		52
Pune me dorë		7
Komunikimi		20
Udhëheqja		4
Kuptim të marrëdhënieve abstrakte		2
Kuptim të fenomeneve natyrore		2
Numri i përgjithshëm i nxënësve të talentuar		198

Qëllime globale të realizuara me nxënës të talentuar. Qëllimet që janë marrë parasysh kur punojnë me nxënës të talentuar janë:

- Zhvillim të aftësive të nxënësit;
- Përmirësimi i arritjeve të nxënësve të talentuar;
- Pjesëmarrja në gara dhe promovimin e nxënësit;
- Zhvillimi normal psiko - fizik i personalitetit të nxënësit të talentuar.

Këto qëllime janë parashikuar të arrihen me realizimin të mëposhtëm

Programe për punë me nxënës të talentuar

Qëllimet specifike	Aktivitetet	Realizues	Koha	Rezultatet e pritshme
Identifikimi i nxënësve të talentuar	Formimi i ekipeve shkollore për punë me nxënës të talentuar - Zhvillimi i një programi për të punuar me nxënësit e talentuar - Informacion për personelin mësimdhënës për aktiviteteve të planifikuara	Personeli i shkollës, shërbim profesional, mësuesit	VIII	- Stafi mësimdhënësve për identifikimin edhe procedurat e punës me nxënës të talentuar - Monitorimi i organizuar i nxënësve të talentuar - Njohje për kapacitetin ekzistues të nxënësve të shkollës - Ngritja e vetëdijes së prindërve në lidhje me mundësitë e fëmijëve të tyre
	- Krahasimi dhe identifikimin i nxënësve të cilët në mënyrë sasiore dhe cilësore përparojnë më shpejtë se sa moshatarët e tyre - Bisedat me kujdestarët të klasave, mësuesit dhe prindërit		IX	
Vlerësimi i talentit	- Vlerësim i cilësive te rezultateve të arritura në mësim. - Testim i aftësive, tiparet e personalitetit dhe aftësive të nxënësve. - Perdorimi i formave moderne mësimore zgjedhje të detyrave, punë në projekte ose esej	Bashkëpunëtor profesional, arsimtar lëndor	X	- Planifikimi, organizimi i mësimdhënies - Burimet të zgjeruara të të dhënave; - Përshtatja e përmbajtjes për nevojat e nxënësve

Qëllimet specifike	Aktivitetet	Realizues	Koha	Rezultatet e pritshme
Sigurim i trajtimit të duhur arsimor edukativ të nxënësit	- Aktivizimi i programeve për punë me fëmijët e talentuar. - Plotësim të programeve të përshtatshme sipas aftësive individuale dhe karakteristikat e nxënësit - Prodhimi i vazhdueshëm i mjeteve individuale për përcaktimin e arritjeve të nxënësve të talentuar - Punë me nxënës të talentuar. - Monitorim i suksesit, rregullshmëria e nxënësve. - Evidentimi i punimeve të nxënësve - Evidentim në instrumentet për monitorimin, vlerësimin e nxënësve.	Bashkëpunëtor profesional, arsimtarët lëndor	**XI**	- Vlerësim real për arritjet; - Ndryshime, plotësim te planit individual të punës me nxënësit; - Caktim të formave, metodat për trajtimin e nxënësit
Përmirësim i arritjeve te nxënësve të talentuar	- Takime me prindërit e nxënësve të talentuar - Punë me arsimtarët për nxënësit të talentuar. - Analiza e arritjeve e nxënësve të talentuar në punë në seksione dhe në realizim të mësimit shtues. - Studim të programeve shtuese, - Përfshirje në ekipe hulumtuese dhe punuese.	Bashkëpunëtor profesional, arsimtarët lëndor, kujdestarët e klasave, prindërit	**XII**	- Respektimin e dallimeve dhe qëndrim korrekt ndaj nxënësve të talentuar, - Socializimin e përmirësuar e nxënësve të talentuar, - Përmirësimi i arritjeve e nxënësve të talentuar
Përcaktim i arritjeve individuale të nxënësve të talentuar	- Monitorim i suksesit, rregullshmëria e nxënësve. - Evidentim ne punimet e studentëve. - Evidentim në instrumentet për monitorimin, vlerësimin e nxënësve.	Bashkëpunëtor profesional, arsimtarët lëndor	**I-II**	Vlerësim real për arritjet; - Ndryshime, plotësim te planit individual të punës me nxënësit; Caktim i formave, metodat për trajtimin e nxënësit.

Qëllimet specifike	Aktivitetet	Realizues	Koha	Rezultatet e pritshme
Përcaktimi i statusit të zhvillimit socio-emocionale të nxënësve të talentuar	Organizimin e takimeve individuale të prindërve me shërbimin profesional me kujdestarin e klasës me prind / kujdestar i nxënësit.	Bashkëpunëtor profesional, arsimtarët lëndor	**III-IV**	Zhvillimi i qëndrimeve pozitive në mesin e nxënësve të tjerë për nxënësit e talentuar
Përcaktimi arritjet individuale të nxënësve të talentuar	- Monitorim i suksesit, rregullshmëria e nxënësve; - Evidentim ne punimet e nxënësve. - Evidentim në instrumentet për monitorimin, vlerësimin e nxënësve.	Bashkëpunëtor profesional, arsimtarët lëndor	**IV**	Vlerësim real për arritjet. - Ndryshime, plotësim te planit individual të punës me nxënësit. Caktim të formave, metodat për trajtimin e nxënësit.
Pregatitja e instrumenteve individuale për përcaktimin e arritjeve të nxënësve të talentuar	- Identifikim i kriterit për vlerësimin e nxënësve të talentuar në përputhje me plan programin mësimor	Bashkëpunëtor profesional, arsimtarët lëndor	**X - V**	Zhvillimi i instrumenteve të veçanta për vlerësimin e nxënësve të talentuar
Mbështetja sociale për zhvillimin e nxënësve te talentuar	- Stimuj materiale: bursa, ndihmë për pajisje, vizita studimore, etj. - Asistencë në orientimin profesional.	Drejtor, Bashkëpunëtor profesional, arsimtarët lëndor, Qeveria - lokale, sektori i biznesit, - shkollat e mesme	**V**	- Përmirësimi i vazhdueshëm dhe status më të lartë social për nxënës
Vlerësimi i programit për punë me nxënës të talentuar	- Përcaktim të dobësive / pikat e forta të aplikimit të programit. - Koncipimi i planit zhvillues për punë me nxënës të talentuar	Bashkëpunëtor profesional, arsimtarët lëndor, kujdestarët e klasave.	**VI-VIII**	- Përgatitja e planeve individuale të punës me nxënës të talentuar; - Përmirësim i arritjeve dhe socializimin e nxënësve të talentuar

Programe individuale për fëmijët me nevoja ndryshe arsimore

Inkluzioni si një proces të përfshirjes së nxënësve me nevoja ndryshe arsimore në shkollat e zakonshme, ngarkon me përgjegjësi për përgatitjen adekuate të shkollës së zakonshme, mësuesit, nxënësit dhe prindërit e fëmijëve të aftë për të pranuar këta nxënës. Kjo me siguri do të thotë se shërbimet profesionale dhe shërbimet për ndihme në shkollat e rregullta duhet të jenë të përgatitur për të ofruar ndihmën e duhur dhe të përshtatshëm të mësuesve dhe të nxënësve me nevoja ndryshe. Hapi i parë dhe më i rëndësishëm është zhvillimi i programeve edukative individuale. Funksioni i zhvillimit të këtyre programeve është një nxënësi me nevoja ndryshe për të ofruar asistencë individuale ose të specializuar në shkollë. Gjithashtu duhet të jemi shumë të kujdesshëm kur bëhet kategorizimi i fëmijës, në qoftë se nuk është bërë më parë. Kur ju thonë se një fëmijë ka pengesa të caktuara, atëherë automatikisht fokusohet vëmendja ne një tipar (karakteristik) ose kusht të përgjithshëm, dhe pjesa tjetër shtypet. Kjo pikëpamje stereotipe e problemit çon në jokalim të pragut për pritjen që një fëmijë mund të arrijë.

Gjatë përgatitjes së programit edukativ të individualizuar janë përcaktuar qëllime me afat të gjatë dhe të shkurtër. Qëllimet afatshkurtra përfshijnë zona të vogla të cilat nxënësit duhet ti kalojnë për ti arritur qëllimet vjetore. Ata janë gjithashtu tregues të qëndrueshmërisë së qëllimeve afatgjata dhe saktësinë e vlerësimit. Duhet të kontrollohen shpesh, nganjëherë në ditë, që të jetë në gjendje të bëhet korrigjim i detyrave të përcaktuara. Qëllimet afatgjata (për një vit), sugjerojnë se çka mund të presim nga nxënësi për të zotëruar vitin shkollor. Duhet të merren parasysh këto gjëra:

- Niveli aktual i mundësive të nxënësve dhe qëllimeve.
- Pas vlerësimit të nxënësit për të bërë qëllimet vjetor për secilën fushë të të mësuarit dhe zhvillimit që ne kemi identifikuar si pak të zhvilluar apo i pazhvilluar.
- Për të marrë në konsideratë nevojat prioritare të fëmijës.
- Qëllimet vjetor duhet plotësisht të jenë te qartë për të gjithë anëtarët e ekipit që realizohet programi punues, si dhe për prindërit.

Partneri prind është një koncept që duhet gjithnjë të forcon besueshmërinë e saj. Sugjerime se prindi mban informacion të vlefshëm në lidhje me fëmijën e tij mund të jetë ndihmë e madhe për mësimdhënësin. Vetëm një prind që e ka kuptuar dhe pranuar gjendjen e fëmijës së tij me nevoja ndryshe, mund të ndihmojë dhe të jetë një partner i suksesshëm me mësimdhënësin në adresimin e të gjitha vështirësive që do të lindin.

Vitin e kaluar në ShFK "Naim Frashëri" Tetovë janë regjistruar nxënës me nevoja ndryshe por që nuk posedojn diagnoz.

Në vijim kemi paraqitur përshkrimin e nevojave të nxënësve si më poshtë në tabelën.

Lloji i nevojave ndryshe	kl	Gjithsej
Pengesa në të folur	I	1
Autizëm	II	1
Çregullime të përziera në zhvillim Epilepsy +	III	1 1
Sindrom Daun Pengesa në të folur Çregullime intelektuale	IV	1 1 1
Autizëm Pengesa në të folur Çregullime intelektuale	V	1 2 1

Paralizë cerebrale-2 Pengesa në të folur Pengesa në zhvillim trupor	VI	1 1 1
Me pengesa në dëgjim-të dëmtuar Çregullime intelektuale	VIII	1 2
Autizëm Çregullime të përziera në zhvillim Çregullime intelektuale Pengesa në zhvillim trupor	IX	2 2 1 1
Numri total i fëmijëve me nevoja ndryshe në shkollë		23

Praktikat e kaluara për pranimin e nxënësve nga ana e bashkëpunëtorëve profesional për nxënësit probleme zhvillimore ose psiko - fizike janë realizuar me procedurat e mëposhtme:

- Vendosja e nxënësit në një klasë të rregullt me nxënës me të cilët ishte i afërt më parë;
- Në klasat ku ka shumë fëmijë me nevoja ndryshe zhvillimore dhe arsimore duhet të shpërndahen në mënyrë të barabartë nëpër klasa;
- Mësuesi që e udhëheq klasën informohet për numrin dhe llojin e fëmijëve me nevoja ndryshe;
- Organizojnë një takim të përbashkët, mësuesit, psikologu, pedagogu, prindi dhe bëhet strategji për punë me nxënësin në shkollë / shtëpi;
- Përfshirja e prindërve në klasë ku ka nxënës me aftësi të kufizuara, socializimin e nxënësve me nevoja ndryshe;
- Metodat e planifikimit të mësimdhënësit, punë aktive, puna në grupe ku do ketë përfshirja të duhur të nxënësve me nevoja ndryshe në procesin arsimor;
- Pedagogu, mësuesi, psikologu i përcjellin arritjet e fëmijës, për sa i përket aftësive të nxënësve;
- Monitorimi dhe vlerësimin e arritjeve të nxënësve me aftësi ndryshe bëhen me metodat, procedurat që i mundësojnë nxënësit të shprehin potencialet e tyre;
- Në rastet kur nxënësi nuk është duke arrit rezultatet në arsim ose shfaqen forma të padëshirueshme të sjelljes (agresiv, lëvizje, vëmendje e shpërqëndruar), kërkohet këshillë nga institucioni përgjegjës për problemin (Qendra për Shëndetin Mendor të Fëmijëve, Qendra për të folurit dhe dëgjim, qendra për fëmijë pediatër-psikiatër);
- Në bazë të mendimit të marrë nga institucionit, defektologu, psikolog, mësimdhënësi, prindi bëjnë modalitetet e veprimit, në përputhje me nevojat e nxënësit, nivelin e tij të zhvillimit, pikëpamjet e prindërve monitorohet vazhdimisht zbatimi e veprimeve.

Programi për punë me nxënësit me nevoja ndryshe

Qëllimet specifike	Aktivitetet	Realizues	Koha	Rezultatet e pritshme
Zbulimi dhe identifikimi i nxënësve me nevoja të posaçme.	- Identifikimi i nxënësve me nevoja të veçanta. - Bisedat me kujdestarët të klasave. - Formimi i ekipit për bashkëpunim. - Përcaktimi i kohës dhe mënyrave për bashkëpunim me psikolog, mësimdhënës, prindër, institucion me të cilin do të punohet për një problem të veçantë.	Shërbimi profesional, mësimdhënës.	IX-V	- Pasqyrë e nxënësve dhe lloji i nevojave ndryshe, - Formim i ekipit për bashkëpunim.
Individualizimin e mësimit, duke iu përshtatur metodave mësimdhënies-vlerësimit për nevojat e nxënësit.	- Puna profesionale konsultative e ekspertëve profesional për nxënës të me nevoja ndryshe. - Format. - Zbatimi modern i arsimit. - Plani. - Përgatitja. - Edukimi individual për çdo nxënës. - Përgatitja individuale dhe mendimi nga institucioni i përshtatshëm professional.	Shërbimi profesional, mësimdhënës.	X	- Planifikimi, organizimi i mësimit, - Burimet, - Të dhënat, - Përmbajtja, - Përshtatja për përmbajtje e nevojave të nxënësve.
Përcaktim i arritjeve individuale të nxënësve me aftësi të kufizuara	- Monitorimi i suksesit të frekuentimit të nxënësve. - Vështrim në punën e nxënësve. - Vështrim në instrumentet për monitorim, vlerësimi të nxënësve. - Takim me nxënësit me nevoja ndryshe. - Takim me prindërit e nxënësve me nevoja ndryshe. - Takim me kryetarët e klasave të nxënësve me nevoja ndryshe - Plani. - Vështrim në edukimin individual për çdo nxënës.	Shërbimi profesional, mësimdhënës.	XI, I, IV, VI	- Vlerësim real për arritjet; - Ndryshimet, - Plotësimet e planit individual të punës me nxënësit; - Përcaktimi i formave të duhura / metodat e punës me nxënës - Socializmi i përmirësuar - Përmirësimi i arritjeve të nxënësve me nevoja ndryshe.

Programi për Integrimin e edukimit ekologjik në sistemin arsimor të RMV-së

Tema I – Uji

Përmbajtja ekologjike	Lënda	Klasa	Përmbajtja mësimore	Numri i orëve	Koha e realizimit
Rëndësia e ujit për botën e gjallë	Shkenca natyrore	I	- Ndryshimi në mes bimëve dhe gjallesave	1	Nëntor
	Arsim figurativ	V	- Pikturim: Liqeni	1	Qershor
	Gjuhë angleze	VI	- Module 1-Unit 1-Facts “A message in a bottle”	1	Shtator
	Biologji	VII	- Këmbimi i materieve	1	Shtator
	Shkenca natyrore	III	- Me ujë ose pa ujë	1	Dhjetor
	Shkenca natyrore	III	- Çfarë ndikimi ka futja e shumë uji apo pak uji	2	Janar
	Ars. fiz. dhe shënd.	VI	në bimë?	1	Shtator
	Ars. fiz. dhe shënd.	VIII	- Rëndësia e ujit te sportistët	1	Shtator
	Gjuhë shqipe	IV	- Uji	1	Nëntor
	Shkathtësi jetësore	VII	- Një ngjarje e përjetuar	1	Qershor
Burimet e ujit dhe shfrytëzimi i tij	Shkenca natyrore	I	- Nga e marim ujin?	1	Dhjetor
Ndotja e ujit	Shoqëri	V	- Vendpozita dhe karakteristikat natyrore të RMV-së	1	Shtator
Shfrytëzimi racional i ujit	Matematikë	I	- Paraqitja e të dhënave	1	Tetor
	Matematikë	VI	- Mbledhja e të dhënave	1	Nëntor
	Matematikë	VIII	- Paraqitja grafike e funksionit linear	1	Qershor
	Gjuhë angleze	IX	- Module 4-Unit 8 “Must/ Mustn’t”	1	Dhjetor
	Gjuhë angleze	VI	- Module 3-Unite 6 “Choices”	1	Shkurt
	Biologji	VIII	- Rënja	1	Shkurt
	Gjeografi	VII	- Funksioni	1	Dhjetor
	Histori	VII	- Hidrografia	1	Nëntor
	Arsim teknik	VI	- Liqenet	1	Tetor
	Shkenca natyrore	VII	- Egjipti i vjetër	1	Prill
		VI	- Uji për pije	1	Maj
		V	- Trajtimi i ujit	1	Tetor
Sigurimi i ujit	Kimi	VIII	- Nocionet për tretës	1	Tetor
Uji i shëndetshëm	Kimi	VIII	- Tretësirat	1	Tetor
Grumbullimi dhe shfrytëzimi i ujit nga shiu	Matematikë	VII	- Mbledhja e thyesave	1	Shtator
	Histori	VI	- Civilizimet më të vjetra	1	Tetor
	Gjuhë shqipe	IX	- Përdorimi i shkronjave të mëdha	1	Shtator
Analiza e gjendjes së instalimit për furnizimin me ujë	Informatik	VI		1	Dhjetor
Përpilimi i udhëzimeve për shfrytëzimin raconal	Shkenca natyrore	IV		1	Nëntor
Ngritja e vetëdijes së komunitetit më të gjerë (amvisërisë)	Shkenca natyrore	V		1	Prill
Shpërndarja e ujit	Gjeografi	VII		1	Maj
Uji dhe ndryshimet klimatike	Biologji	VII	- Rëndësia e bimëve për kushtet klimatike	1	Qershor
	Histori	VII	- Shpërngulja e sllavëve në Ballkan	1	Tetor
	Arsim figurativ	VI	- Dizajn grafik (pllakatë) vijë, konturë, tekst...	1	Shtator

Tema II – Energjia

Përmbajtja ekologjike	Lënda	Klasa	Përmbajtja mësimore	Numri i orëve	Koha e realizimit
Rëndësia e energjisë për botën e gjallë	Biologji Gjeografi Histori Shkenca natyrore Shkenca natyrore Shkenca natyrore Gjuhë shqipe	VII VII VIII V III III IV	- Fotosinteza - Potenciali hidroenergjetik - Revolucioni industrial në Evropë - Faktorët për mbirjen e farave - Bimët dhe nxehtësia - Bimët dhe drita - Energjia elektrike -Lexim nga revista për fëmijë	1 1 1 1 1 1 1	Mars Prill Shtator Maj Nëntor Nëntor Dhjetor Tetor
Burimet e energjisë dhe shfrytëzimi	Shkenca natyrore	IV	- Burimet e energjis	1	Shkurt
Llojet e energjisë	Shoqëri	V	- Energjia- mundësi alternative	1	Maj
Shfrytëzimi racional i energjisë	Shkenca natyrore Matematikë Matematikë Matematikë Kimi Arsim teknik Arsim teknik Arsim teknik Fizikë	II VIII IX VII IX VI V IV	- Dielli ynë - Diagrami sektorial - Zgjidhja e barazimit linear (ushtrime) - Sasia e përqindjes - Yndyrat dhe vajrat -Kursimi i energjisë në ndërtesë - Teknologjia solare -Shfrytëzimi i energjisë natyrore - Ligji mbi ruajtjen e energjisë	1 1 1 1 1 1 1 1	Dhjetor Maj Nëntor Tetor Maj Prill Dhjetor Mars
Sigurimi i energjisë nëpërmjet të burimeve alternative: sistemi diellor/ fotovoltaik/ mulli me erë					
Përpilimi i udhëzimeve për shfrytëzimin raconal të energisë					
Analiza e gjendjes së instalimit elektrik					
Ngritja e vetëdijes së komunitetit më të gjerë (amvisërisë, komunitetit lokal dhe ngjashëm)	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze Gjuhë angleze	V VIII	- Tregimi i ngjarjes së përjetuar - Processing of a text: Daily life: repeated actions - Module 2-Unit 4-Places	1 1 1	Prill Shtator Tetor
Shpërndarja e energjisë					
Lidhja midis energjisë dhe emetimit të dyoksid karbonit					
Energjia dhe ndryshimet klimatike	Matematikë Gjuhë shqipe	V IX	- Ndryshimet e temperaturës - Përcaktuesit e emrit	1 1	Shtator Tetor
Energjia dhe zhvillimi i qëndrueshëm					
Rëndësia e energisë për botën e gjallë					

Tema III: Mirëmbajtja e ndërtesës dhe mjedisit të shëndoshë në shkollë / kopsht

Përmbajtja ekologjike	Lënda	Klasa	Përmbajtja mësimore	Numri i orëve	Koha e realizimit
Rëndësia e higjienës në ndërtesën	Arsim figurativ Matematikë Kimi	V VII VIII	- Spektri i ngjyrave - Figura e puthitëshme - Acidet	1 1 1	Shtator Nëntor Prill
Mjete ekologjike për mirëmbajtjen e higjienën	Gjuhë shqipe Kimi Shkenca natyrore	V VIII III	- Në bibliotekë- klasifikimi, rradhitje librash - Acidet - Kultivimi i bimëve	1 1 1	Shtator Prill Nëntor
Ngjyrat ekologjike për ngjyrosje					
Sendet të cila nuk përdoren					
PVC ambalazhi					
Ngritja e vetëdijes së komunitetit më të gjerë për higjienën dhe mjedisin e shëndoshë					
Ndikimi i higjienës mbi shëndetin	Shkathtësi jetësore Matematikë Gjuhë angleze Gjuhë maqedone Shoqëri Ars.fiz. dhe shën Ars.fiz. dhe shën Shkathtësi jetësore	II VI VI IX III IX VI IV	- Kujdesi për higjenën personale - Puna me të dhëna - Module 3-Unit 6 “Good and bad habits” - Higjiena ime, përgjegjësia ime - Sporti dhe higjiena - Sporti dhe higjiena - Kujdesi për higjienën personale	1 1 1 1 1 1 1 1	Prill Tetor Dhjetor Maj Prill Tetor Tetor Qershor
Ndikimi i njeriut mbi mjedisin jetësor	Gjuhë shqipe	V	- Zhvillim teksti: Eko aksion	1	Mars
	Gjuhë shqipe Gjuhë angleze Gjuhë angleze	V IX VII	- Poezia: Pranvera - Unit 7: The world we live. Reading: Paradise lost. - Module 6-Unit 12 “Who cares”	1 2 1	Mars Dhjetor Maj
Analiza e gjendjes në ndërtesën shkollore	Gjuhë angleze	VI	- Life and culture: ”Schools”	1	Dhjetor

Tema IV: Oborri i rregulluar

Përmbajtja ekologjike	Lënda	Klasa	Përmbajtja mësimore	Numri i orëve	Koha e realizimit
Rëndësia e oborrit	Matematikë Shkathtësi jetësore Arsim teknik Shoqëri	VII IX V III	- Perimetri i paralelogramit - Mbrotja e mjedisit jetësor - Prej idesë deri tek realizimi - Oborri i shkollës	1 1 1 1	Mars Maj Dhjetor Tetor Nëntor
Biodiversiteti në oborr	Biologji	IX		1	Qeshor
Analiza e funksionalitetit të oborrit					
Rëndësia e higjienës në oborr	Shoqëri Gjuhë maqedone Arsim teknik	II VIII V	- Jeta dhe puna në shkollë - Ushtrime të të folurit: anekdota dhe shaka nga jeta shkollore. - Kultura e punës në puntorinë e shkollës	1 1 1	
Ngritja e vetëdijes së komunitetit më të gjerë për higjienën në oborr	Shoqëri Shkathtësi jetësore Gjuhë shqipe	I IX VII	- Të krahasojmë kopshtin me shkollën - Sjellja në vende publike - Një emision në RTV	1 1 1	
Përpilimi i udhëzimit për mirëmbajtjen e oborrit					
Ujitja (vaditja) e sipërfaqeve të gjelbra	Shkenca natyrore Matematikë Matematikë	I VIII VI	- Kultivimi i bimëve të larta - Syprina e drejtkëndëshit dhe katrorit	1 1 1	

Tema V: Mbeturinat (plehrat)

Përmbajtja ekologjike	Lënda	Klasa	Përmbajtja mësimore	Numri i orëve	Koha e realizimit
Llojet e mbeturinave	Kimi Gjuhë shqipe	IX IX	- Materialet plastike dhe fijet sintetike - Mënyra kushtore dhe kohët e saj	1 2	Mars Dhjetor
Analiza e gjendjes së mbeturinave në ndërtesë dhe në oborr					
Seleksionimi i mbeturinave	Shoqëri Matematikë Matematikë Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze Arsim figurativ Arsim teknik Arsim teknik	I VIII VI VIII VII IX VII V VII	- Rregullat e shkollës - Mesi aritmetik, moda, mediana - Përqindja - Module 5- Unit 10 “Where is it made” - Module 6-Unit 12 “Everyday material” - Unit 7 –The world we live in - Dizajn industrial - Materialet letra – kartoni - Mbledhja e materialeve të përdorura	1 1 1 1 1 1 2 1 1	Tetor Prill Dhjetor Maj Maj Nëntor Prill Tetor Dhjetor
Riciklimi	Arsim figurativ Shkenca natyrore Arsim teknik	VIII III IV	- Dizajn industrial - Të studjojm letrën - Riciklimi i letrës së vjetër	2 1 1	Maj Dhjetor Dhjetor
Ripërdorimi					
Deponitë dhe deponitë e paligjshme					
Ndikimi i mbeturinave mbi shtndetin dhe mjedisin jetësor	Gjeografi	IX	- Ndotja dhe mbrojtja e mjedisit jetësor	1	Qershor
Ngritja e vetëdijes së komunitetit më të gjerë për menaxhimin me mbeturinat					
Përpilimi i udhëzimit për menaxhimin me mbeturinat					
Analiza e gjendjes së mbeturinave në ndërtesë dhe në oborr					
Plani për zvogëlimin e mbeturinave					

Tema VI: Biodiversiteti

Përmbajtja ekologjike	Lënda	Klasa	Përmbajtja mësimore	Numri i orëve	Koha e realizimit
Biodiversiteti lokal dhe kombëtar					
Analiza e biodiversitetit për mjedisin lokal					
Aksionet ekologjike	Matematikë Matematikë Gjuhë angleze Gjuhë angleze Biologji Shkenca natyrore Shkathtësi jetësore Gjuhë shqipe	VIII VI IX VII IX III IV VII	- Rafshi koordinativ - Mesi aritmetik - Unit 7: What's on tonight? - Module 3-Unit 5: Extra reading: "The eco challenge race" - Vendi dhe roli i njeriut në biosferë - Eko – patrolla - Dita e planetit Tokë - Ruajtja e mjedisit	1 1 1 1 1 1 1 1 1 1	Prill Prill Dhjetor Dhjetor Qershor Prill Mars Qershor Maj Shkurt
Ndikimi i njeriut mbi biodiversitetin	Gjuhë angleze	VII	- Module 6-Unit 6 "The world fund for nature"	1	Maj
	Gjuhë angleze Gjuhë shqipe	IX IX	- Unit 13-School life - Vyrtitet kryesore të njeriut	1 1	Mars Shkurt
Ndikimi i ndryshimeve klimatike mbi biodiversitetin					
Ngritja e vetëdijes së komunitetit më të gjerë për biodiversitetin lokal					
Ndikimi i mbeturinave mbi biodiversitetin					
Përpilimi i udhëzimit për biodiversitetin					

Tema VII: Transporti

Përmbajtja ekologjike	Lënda	Klasa	Përmbajtja mësimore	Numri i orëve	Koha e realizimit
Llojet e transportit	Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze	V V VIII	- Vocabulary: Our holiday - Histori transport - Methos of transport	1 1 1	Dhjetor Janar Shtator
Ndikimi i transportit mbi shëndetin	Matematikë Gjeografi	VIII VII	- Mbledhja e vektorëve - Komunikacioni	1 1	Shtator Maj
Ndikimi i transportit mbi mjedisin jetësor					
Analiza e gjendjes së transportit lokal					
Transporti dhe siguria					
Ngritja e vetëdijes së komunitetit më të gjerë për shfrytëzimin e transportit publik dhe biçikletës	Shoqëri Shoqëri Matematikë Biologji Arsim teknik Arsim teknik Ars.fiz. dhe shën Ars.fiz. dhe shën	I II VII IX V V VI VIII	- Mjetet e lëvizjes në rrugë - Para udhëkryqit /aktivitet: vëzhgim në udhëkryq - Njësitë matëse - Sistemi i qarkullimit të gjakut - Komunikacioni - Bicikleta ime - Përdorimi i biçikletës si mjet transportues	1 1 1 1 1 1 1 1	Maj Qershor Tetor Dhjetor Prill Maj Maj Shkurt
Shfrytëzimin i biçikletës	Arsim teknik	V	- Përdorimi i biçikletës si mjet transportues	1	Prill
Përpilimi i udhëzimit për shfrytëzimin e transportit publik dhe biçiklet	Matematikë	IX	- Pika, drejtëza dhe rrafshi në hapësirë	1	Shkurt

Tema VIII: Shëndeti

Përmbajtja ekologjike	Lënda	Klasa	Përmbajtja mësimore	Numri i orëve	Koha e realizimit
Ushqimi organik	Shoqëri Biologji Kimi Histori Gjuhë maqedone Shkathtësi jetësore Shkathtësi jetësore Gjuhë shqipe	I IX IX VII IV IV IV VII	- Ritemi të lumtur - Ushqimi dhe rëndësia e të ushqyerit - Materiet organike (rëndësia e yndyrave dhe vajrave) - Zbulimet e mëdha gjeografike - Говорна вежба: Овошје и зеленчук - Sallatë ose sendviç - Lënda djegëse organike - Ushtrime gjuhësore	1 1 1 1 1 1 1 1	Nëntor Tetor Maj Tetor Dhjetor Prill Maj Prill
Piramida e të ushqyerit	Shkathtësi jetësore Gjuhë angleze Biologji Arsim figurativ Shkenca natyrore Ars. fizik dhe shën Shkathtësi jetësore Gjuhë shqipe	II V IX VII III VI IV IX	- Përvetësimi i shprehive për ushqim të shëndetshëm - Food and drink; vocabulary - Sistematizimi i të ushqyerit - Harmoni me ngjyra - Llojet e ushqimit - Njohtimi i nxënësve me piramidën e të ushqyerit - Piramida e të ushqyerit - Pranvera në shpirt e natyrë	1 1 1 1 1 1 1 1	Prill Shkurt Nëntor Dhjetor Shtator Nëntor Maj Prill
Ndikimi i aktivitetit fizik mbi shëndetin	Arsim fizik dhe shënd Arsim fizik dhe shënd Matematikë Matematikë Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze Biologji Arsim teknik Arsim teknik Shkenca natyrore Ars.fizik dhe shënd Ars.fizik dhe shënd Ars.fizik dhe shënd Ars.fizik dhe shënd	II V VIII VI VI IX IX VII VII IX IX V V III VII IV	- Ecje të ngadaltë dhe të shpejtë - Ndikimi i aktivitetit fizik mbi shëndetin - Madhësitë proporciale të drejta - Proporcioni - Module 1-Unit 2. ”Are you ready?” - Unit 3. Are you a good teenage sport? - Reading: Teenage sports phenomena. - Activity sports - Kujdesi dhe deformimet e sistemit për lëvizje -Bicikleta ime - Vozitja e biciklетës në poligon e më gjërë - Bëhu aktiv - Aktiviteti fizik në jetën e përditshme - Aktiviteti fizik në jetën e përditshme - Balans ndërmjet aktivitetit fizik dhe ushqimit - Përvetësimi i shprehive për zhvillim të drejtë fizik	1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1 1	Nëntor Nëntor Mars Mars Shtator Tetor Tetor Tetor Prill Maj Mars Tetor Nëntor
Ndikimi i të ushqyerit mbi shëndetin	Gjuhë angleze Gjuhë angleze	IX V	- Unit5. Healthy eating -Cultural theme: Meals and meal time	1 1	Tetor Mars
Ngritja e vetëdijes së komunitetit më të gjerë për shfrytëzimin e ushqimit të shëndoshë	Arsim figurativ	VIII	- Dizajn grafik (reklamë, billbord)	2	Mars
Përpilimi i udhëzimit për shfrytëzimin e ushqimit të shëndoshë	Gjuhë angleze Gjuhë angleze	V VI	- Describing a recipe - Module 3-Unit 6. ”A survey about foot”	1 1	Mars Dhjetor

Tema IX: Zhvillimi i qëndrueshëm

Përmbajtja ekologjike	Lënda	Klasa	Përmbajtja mësimore	Numri i orëve	Koha e realizimit
Definicioni dhe rëndësia e zhvillimit të qëndrueshëm					
Rëndësia për ruajtjen e habitateve natyrore	Gjuhë angleze Gjuhë angleze Gjuhë angleze	V V VII	- Vocabulary: My country - Mickey and Millie go camping - Modern inventions. It's a paradise"	1 1 1	Prill Prill Janar
Pabarazia lokale, kombtare dhe globale					
Drejtësia sociale	Shoqëri	V	- Socializimi i personit në grup	1	Dhjetor
Shfrytëzimi racional i resurseve natyrore					
Përgjegjësia ndaj mjedisit jetësor	Shoqëri Shkathtësi jetësore Gjuhë angleze Biologji Gjeografi Gjuhë maqedone Gjuhë maqedone Shkathtësi jetësore	VII VIII IX IV V V IV	- Rregullat tona - Mbrojtja e planetit tonë - Modern inventions. It's a paradise" - Faktorët ekologjik - Elementet natyror të mjedisit jetësor - Текстот: Излет - Текстот: Дрвце - Mbeturina, ndotja	1 1 1 1 1 1 1 1 1	Maj Qershor Janar Maj Maj Tetor Mars Prill Qershor
Konsumimi i përgjegjshëm dhe racional					
Ngritja e vetëdijes së komunitetit më të gjerë për aktivizmin qytetar					
Definicioni dhe rëndësia e zhvillimit të qëndrueshëm					

Të arriturat e nxënësve

Shkolla disponon me të dhënat për të arriturat e nxënësve në të gjitha lëndët mësimore dhe të gjitha periodat kualifikuese. Bëhen krahasime të notës mesatare, sjellja dhe rregullshmëria, si dhe të arriturat sipas gjinisë së nxënësve. Përkatësia etnike nuk paraqitet si variabël tek të arriturat e nxënësve sepse nuk kemi përkatësi të tjera etnike.

Nota mesatare e të arriturave të nxënësve gjatë tri viteve të kaluara shkollore, është dhënë në tabelën e mëposhtme:

Viti shkollor	2022 / 2023	2023 / 2024	2024 / 2025
Nota mesatare	3.85	3.65	3.93

Shkolla ka promovuar bindje se të arriturat e të gjithë nxënësve mund të përmirësohen dhe organizohen mësime shtuese, plotësuese dhe aktivitete të lira. Çdo arsimtarë në fillim të vitit shkollor ka përgatit programin vjetor për këto forma të mësimit. Në nivel të mësimit lëndor është përgatitet orari për realizimin e këtyre programeve, sipas orëve të planifikuara për mësim plotësues, shtues dhe aktivitete të lira në kornizë të një paraleleje. Për mësimin shtues janë të përgatitura edhe lajmërime të posaçme gjer tek prindërit e nxënësve tek të cilët janë vërejtur vështirësi në materialin mësimor në lëndë të caktuara. Gjithashtu, mësimi i rregullt Në vazhdimësi po përparon me projekte të reja, teknika dhe metoda të punës.

Nxënësit që kishin vështirësi në mësime, si dhe ata me nevoja ndryshe arsimore, së pari identifikohen gjatë regjistrimit në klasën e parë (pyetësorë në të cilat vet prindi tregon problemet e fëmijës, mendim nga Enti për shëndet mental, vërtetim mjekësor) por nëse më vonë vërehet problemi, bisedohet me arsimtarin, nxënësin dhe prindin- dhe konsultohen institucionet kompetente. Të arriturat e nxënësve në këtë rast vlerësohen në përputhje me planin operativ individual dhe qëllimet në qasje të diferencuar. Inkurajohet përparimi individual sipas aftësive vetjake, pa i krahasuar me nxënësit tjerë. Nxënësit e talentuar identifikohen gjatë orës së mësimit ku arsimtari i vëzhgon dhe merr shënime anekdotike, notim, evidencë vetjake të çdo arsimtari veç e veç. Në shkollë nuk mbahen testime interne në plot kuptimin e fjalës, mirëpo bëhen gara interne nga lëndë të ndryshme në nivel të gjeneratave, që të bëhet selektimi i nxënësve më të mirë që do të marrin pjesë në gara qe organizohen.

Në shkollë është sjellë Rregullorja për shpërblime dhe lëvdata të nxënësve dhe në përputhje me këtë Rregullore zgjidhet paralelja më e mirë, nxënës i gjeneratës, shpërblehet nxënësi që ka arritur sukses të shkëlqyeshëm Në vazhdimësi gjatë shkollimit fillor si dhe nxënësit që kanë kontribuar në afirmimin e shkollës.

Informimi i nxënësve dhe publikut më të gjerë për punën dhe rezultatet e arritura të shkollës do të bëhet në vazhdimësie gjatë tërë vitit. Informimi do të bëhet në mënyrë direkte dhe paraqitjeve të drejtpërdrejtë të drejtorit apo personit të autorizuar nga shkolla, gazeta dhe revista të ndryshme si dhe gazeta te tjera adekuate, si dhe nëpërmjet radios dhe televizionit dhe faqja e shkollës në rrjetet sociale.

Shkolla i përcjell të arriturat e nxënësit në kalimin në shkollë të mesme. Në shkollë na sjellin lajmërime për nxënësit tanë se në cilat shkolla të mesme janë regjistruar, por jo dhe informata për suksesin e arritur të të njëjtëve. Si ndihmë për vendosjen e nxënësve në zgjedhjen e shkollimit të mesëm në të cilën do të regjistrohet, pedagogu i shkollës përgatit dhe realizon **Programin për orientim profesional të dedikuar për nxënësit e klasës së nëntë.** Nëse ekzistojnë mundësitë që të organizohen vizita të nxënësve nëpër shkolla të mesme, apo të sigurohen mësimdhënës të cilët do të i njoftojnë nxënësit me drejtimet e ndryshme të

shkollimit profesional. Janë organizouar dhe vizitë na Panairin e arsimimit ku do të prezantohen shkollat e mesme nga RMV.

Aktivitetet	Resurset	Bashkëpunëtorët	Koha e realizimit
Anketë me nxënësit	Lista anketuese	Nxënësit	mars
Vizita nga ana e shkollave të mesme dhe prezantim para nxënësve	Material promovues për shkollë të mesme, materialpër prezantim	Përfaqësues të shkollave të mesme, profesor, nxënës	mars - prill
Rishikim i konkursit për regjistrim në shkolla të mesme	Konkurs	Nxënës, prind, kujdestar klase	prill
Aplikimi i serisë DAT në orientimin profesional	este, analiza, raport	Nxënës – kujdestar klase	prill – maj
Aplikimi i testeve për aftësie dhe orientimit profesional	Teste, analiza, raport	Nxënës – kujdestar klase	prill – maj
Prezentim i rezultateve të arritura – intervistë me nxënësit	Teste, analiza	Nxënës, prind, kujdestar klase	prill – maj
Bisedë me nxënësit	Konkurs për regjistrim në shkollë të mesme, materiale promovuese	Nxënës	maj

Programet preventive

Në shkollën tonë realizohen programe preventive nëpërmjet të të cilave kemi për qëllim të krijojmë siguri dhe klimë të duhur për punë të të gjitha subjekteve në shkollë. Vëmendje të posaçme i kushtojmë çdo llot të dhunës në shkollë për të cilën shkolla ka përgaditur një ekip i cili ka përgatitur një Protokoll për mbrojtjen e nxënësve nga dhuna, keqpërdorim dhe dhe abuzimeve në shkollë. Përgjegjësia e të gjithë subjekteve në shkollë është që të udhëheqin politikë kundër dhunës. Shkolla është e kyçur në projektin “Zvogëlimi i dhunës në shkollë- si të ndryshohen gjërat”. Projekti realizohet nëpërmjet procesit edukativo-arsimor dhe organizimin e punëtorive edukative për prindërit, nxënësit dhe arsimtarët, me qëllim të njohjes së tyre dhe bashkëngjitja në të gjitha aktivitetet e parapara.

Në kornizat e programit për mbrojtje shëndetësore, si dhe programit për aftësitë jetësore, nxënësit janë njoftuar me sëmundjet dhe preventiva prej të njëjtave. Një pjesë nga këto programe të preventivës realizohet edhe gjatë mësimit të rregullt në lëndët dhe orët me përmbajtje adekuate.

Mbrojtja nga zjari, përmbytja dhe tërmete janë të paraparë sipas planit vijues:

Mbrojtje nga zjarri, termeti dhe fatkeqësi tjera

Temat për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësi tjera janë përfshi në plan-programet mësimore të arsimtarëve si aktivitete jashtëmësimore (aktivitete të lira të nxënësve):

1. Klasa e parë: Zjarrëfiksit, profesioni, si duket një zjarrfikës dhe pajisjet personale.

2. Klasa e dytë: Njoftim elementarë me zjarrin, dobitë e tij dhe rreziqet nga ai.

3. Klasa e tretë: Rreziqet nga zjarri: gjatë përdorimit të pajisjeve për ngrohje, rreziqet nga hekuri, ngrohëset dhe rreziqetnga lojrat e fëmijëve.

4. Klasa e katërt: Burimet e rrezikut nga zjarri (në shtëpi, në shkollë dhe në ambient – rrethinë ku fëmijë luajnë ose qëndrojnë)

5. Klasa e pestë: Rreziqet dhe shkaqet për ndodhje të zjarreve nga flaka e hapur.

6. Klasa e gjashtë: Si ndodhë procesi i djegjes dhe zjarri.

7. Klasa e shtatë: Llojet e zjarreve sipas madhësisë dhe vendit të paraqitjes.

8. Klasa e tetë: Aparatet kunder zjarrit të dorës (me shkumë, pluhur të thatë, CO2 etj)

9. Klasa e nëntë: Pajisjet dhe mjetet zjarrëfikse.

Plani i ekipit të formuar në shkollë për mbrojtje nga zjarri dhe fatkeqësi tjera

Përmbajtja–aktiviteti	Qëllimet	Realizues	Resurse	Efektet e pritura	Koha
Testimi i shenjës për rrezik	Përcaktimi i sinjalit të vërtetë	Ekipi për planifikim	Plan	Nxënësit e njohin shenjën	Shtator
Ushtrimi i aktivitetitkundër zjarrit gjatë mësimit lëndor	Aftësimi i ekipit përveprim të shpejtë	Ekipi për mbrojtje nga zjarri	Aparat et kundër zjarrit	Ekipi është i aftë për aksion	Nëntor
Evakuimi për aktivitetin e realizuar	Rishikimi i dobësive	Ekipi i arsimtarëve	Plan dhe procesverbal	Lëshimet janë vërejtur dhe eliminuar	Nëntor
Aktivitet ushtrues në klasat e ulëta për alarmkundër zjarrit	Aftësimi i ekipit përveprim të shpejtë	Ekipi për mbrojtje nga zjarri	Aparat et kundër zjarrit	Ekipi është aftësuar për aksion	Mars
Evakuimi për aktivitetin e realizuar	Rishikimi i dobësive	Ekipi i arsimtarëve	Plan dhe procesverbal	Lëshimet janë vërejtur dhe eliminiur	Mars
Testimi i shenjës për rrezik	Kontrollimi i suksesit të shenjës	Ekipi për planifikim	Plan	Nxënësit e njohin shenjën	Prill

Aktivitet ushtrues për dhënien e ndihmës së parë	Aftësimi i ekipit përndihmë të parë	Ekipi për ndihmën eparë	Materialet medicinale	Intervenimi praktik i suksesshëm	Maj
Evalvimi i aktiviteteve të realizuara	Rrishikimi i amëve pozitive dhe negative	Ekipi i arsimtarëve	Procesverbale	Masat e ndërmarra janë vërejtur	Maj

11. Notimi (vlerësimi)

Në shkollë në mënyrë të vazhdueshme është monitoruar dhe vlerësohet, notohet, suksesi i arritur i nxënësve. Vëzhgimi i arritjes së nxënësve është bërë individualisht dhe kolektivisht, në grup, në varësi të fenomeneve pedagogjike. Kjo bëhet me anë të mjeteve të përshtatshme dhe teknikat (me gojë dhe me shkrim, teste, ushtrime me shkrim, hartime me shkrim, detyra kontrolluese, ese, projekte, vëzhgime, etj) me çfarë mblidhen të dhënat dhe pastaj të njëjtat evidentohen dhe përpunohen. Vlerësimi i nxënësve bëhet sipas kritereve dhe standardeve të përcaktuara nga Ministri i Arsimit dhe Byroja për Zhvillimin e Arsimit.

Llojet e vlerësimit dhe kalendari i vlerësimit

Në shkollë është bërë vlerësimi i brendshëm i të arriturave të nxënësve që është i vazhdueshëm gjatë gjithë vitit shkollor, duke analizuar situatën në të katër periudhat e klasifikimit dhe vlerësimit të jashtëm në fund të vitit shkollor.

Arritjet e nxënësve në shkollë janë vlerësuar në mënyrë përshkruese dhe numerikisht. Në periudhën e parë (nga kl. e I deri e III-të) janë vlerësuar në mënyrë përshkruese, në periudhën e dytë (klasa IV-VI) të arriturat e nxënësve në lëndët obligative dhe në lëndët zgjedhore, vlerësimi i të arriturave bëhet në mënyrë përshkruese dhe në fund të vitit vlerësimi bëhet numerikisht. Nxënësit nga periudha e tretë (klasa VI-IX) vlerësohen numerikisht me nota nga (1) deri (5).

Nxënësi nga klasa e parë deri në të pestën, si rregull, nuk mund të përsërisë klasën. Nxënësi i cili nuk ka arritur të zotërojë përmbajtjet mësimore deri në fund të vitit shkollor, për shkak të mungesës së shkollës apo për shkak të sëmundjes, zhvendosjes dhe shkaqe të tjera të arsyeshme, me propozimi të prindit apo kujdestarit të klasës dhe bashkëpunëtorëve profesional të shkollës dhe në pajtueshmëri me prindërit mund të qëndrojë në të njëjtën klasë, për çfarë vendos këshill i shkollës.

Gjatë punës edukativo-arsimore arsimtarët kanë ndjekur ecurinë e nxënësve në mënyrë individuale me qasje individuale në punë. Zbatimi i standardeve të dhëna na BZHA është i detyrueshëm.

Si aktivitet kryesor i çdo mësuesi në çdo periudhat e klasifikimit është nxitja e nxënësit për të zotëruar njohuri në nivele më të larta të dijes sipas standardeve (të kujtuarit, të kuptuarit, zbatimi, analiza, sinteza dhe vlerësimi). Nga mësuesit pritet të kryhen kontrolle të vazhdueshme për njohuri me shkrim, ku do të zbatohen kriteret dhe standardet e vlerësimit. Mësuesit planifikojnë dhe kryejnë vlerësim tremujor - vlerësim sumativ (përmbledhës, me gojë ose me shkrim), duke përdorur metoda të ndryshme të vlerësimit sumativ, ndërsa gjatë vitit vlerësojnë në mënyrë formative. Për shkak të përmirësimit të njohurive të nxënësve edhe metodat formative përdoren për qëllime sumative, që do të sigurojnë vazhdimësinë dhe besueshmërinë e vlerësimit.

Kujdestari i klasës apo kujdestari i paraleles është i detyruar që për suksesin e nxënësve t`i informojë prindërit të paktën katër herë gjatë vitit shkollor. Informacionet kanë të bëjnë me fenomenet e mëposhtme pedagogjike: suksesi i përgjithshëm sipas lëndëve, rregullshmëria e nxënësve dhe sjellja e nxënësve.

Monitorimi dhe kontrollimi i progresit dhe arritjes së suksesit të nxënësve bëhet, përveç me vlerësim të brendshëm edhe me vlerësimi të jashtëm. Vlerësimi i jashtëm i arritjes së suksesit të nxënësve në fund të çdo

viti mësimor për nxënësit nga klasa e katërt deri në klasën e organizon dhe e zbaton shkolla nëpërmjet të komisionit shkollor. Komisioni shkollor për vlerësimin e jashtëm të arritjeve të nxënësve është i përbërë nga pesë anëtarë:

1. Gzime Alili - drejtor
2. Fatime Bexheti Durmishi - nëndrejtor dhe mentor i shkollës
3. Dugagjin Muharemi - pedagog
4. Medina Alili - psikolog
5. Adile Abdii - Edukator special dhe rehabilitues
6. Arijeta Beqiri - sociolog
7. Gjylfer Murati – Bibliotekist

Metoda e formimit dhe e funksionimit të komisionit shkollor, fshehtësia e materialit për vlerësimin e jashtëm, mënyra dhe procedura kontrollimit të testeve komisioni shkollor si dhe formën dhe përmbajtjen e raportit i përcakton Ministri me propozim të Qendrës shtetërore të testimit. Vlerësimet shtetërore i arritjes së suksesit të nxënësve kryhet me teste të përgatitura nga Qendra e Provimit Shtetëror me propozim të Byrosë. Verifikimi i jashtëm i arritjes së suksesit të nxënësve bëhet në katër lëndë mësimore, sipas plan-programit, ndërsa në bazë të planit të përgjithshëm të përgatitur nga Qendra e Provimit Shtetëror me propozim të Byrosë. Në bazë të orarit të përgjithshëm të komisionit të shkollës përgatit një plan të brendshëm sipas paraleleve, lëndëve mësimore dhe arsimtarëve për kryerjen e testimit në shkollë.

11.1. Monitorimi dhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve në shkollë në vitin shkollor 2024/2025 është bërë sipas planit në vijim:

Detyra	MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE														
	Korniza kohore (muaji)										Monitorimi				
Aktivitete	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	**Bartës**	**Mënyra e zbatimit (resurse)**	**Instrumente**	**Rezultaet e pritura**	**Personi përgjegjës**
Vlerësimi sumativ numerikisht i të arriturave të nxënësve nga të treshja e dytë (IV - VI)											Më simdhënës	Prezantim me gojë, diskutime, kontrollime me shkrim aktivitete projektuese, vetë- vlerësim, duke përfshirë vlerësimin e nxënësve, portofol nxënësi	Fletë mësimore, teste kontrolli, detyra projektuese, kuiz - pyetje, detyra shtëpie, lista kontrolli, listat analitike, lista holistike	Përmirësimi i të mësuarit dhe mësimdhënia	Drejtori Nëndrejtor Pedagog
Vlerësimi sumativ numerikisht i të arriturave të nxënësve nga të treshja e tretë (VII, VIII dhe IX)											Më simdhënës	Përmbledhja e arritjeve të nxënësve gjatë një periudhe, në përputhje me standardet dhe kriteret e vlerësimit	Lista evidentuese për aktivitetet dhe arritje , standarde dhe kriteret e vlerësimit		Drejtori Nëndrejtor Pedagog
Vlerësimi sumativ i të arriturave të nxënësve me kontrollim me shkrim (hartime me shkrim)											Më simdhënës	Përmbledhja e arritjeve të nxënësve gjatë një periudhe, në përputhje me standardet dhe kriteret e vlerësimit	Lista evidentuese për aktivitetet dhe arritje, standarde dhe kriteret e vlerësimit		Drejtori Nëndrejtor Pedagog

Detyra	MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE														
	Korniza kohore (muaji)										Monitorimi				
Aktivitete	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	**Bartës**	**Mënyra e zbatimit (resurse)**	**Instrumente**	**Rezultaet e pritura**	**Personi përgjegjës**
Vlerësimi formativ i të arriturave të nxënësve (me gojë ose me shkrim)											Më simdhënës	Prezantim me gojë, diskutime, kontrollime me shkrim aktivitete projektuese, vetë-vlerësim, duke përfshirë vlerësimin e nxënësve, portofol nxënësi	Fletë mësimore, teste kontrolli, detyra projektuese, kuiz - pyetje, detyra shtëpie, lista kontrolli, Listat analitike, Lista holistike	Përmirësimi i të mësuarit dhe mësimdhënia	Drejtori Nëndrejtor Pedagog
Vlerësimi sumativ përshkrues i arritjeve të nxënësve nga treshja e parë (I -III)											Më simdhënës	Përmbledhja e arritjeve të nxënësve gjatë një periudhe, në përputhje me standardet dhe kriteret e vlerësimit	Lista evidentuese për aktivitetet dhe arritje, standarde dhe kriteret e vlerësimit		Drejtori Nëndrejtor Pedagog
Vlerësimi sumativ përshkrues i arritjeve të nxënësve nga treshja e dytë (IV - VI)											Më simdhënës	Përmbledhja e arritjeve të nxënësve gjatë një periudhe, në përputhje me standardet dhe kriteret e vlerësimit	Lista evidentuese për aktivitetet dhe arritje, standarde dhe kriteret e vlerësimit		Drejtori Nëndrejtor Pedagog

Kontrolle me shkrim të arritjeve të nxënësve janë bërë sipas një plani të paracaktuar, në përputhje me rrethanat dhe Ligjin për arsim fillor dhe duke marrë në konsideratë kufizimet (maksimum një herë në ditë dhe dy herë në javë në një klasë të njëjtë). Plani për vitin shkollor 2024/2025 është dhënë në tabelën e mëposhtme:

Monitorimi, analiza dhe mbështetje gjatë vlerësimit

Në shkollë është bërë monitorimi dhe verifikimi i vlerësimit të pajtueshmërisë së vazhdueshme me standardet e përcaktuara. Sipas Ligjit për arsim fillor, janë përcaktuat procedurat për ankesat dhe parashtresat e pranuara pas vlerësimit, si dhe mënyra e informimit të prindërve dhe nxënësve në lidhje me këtë. Monitorimi, analiza dhe mbështetje, lidhur me vlerësimin e kryer nga standardet e përcaktuara e bën udhëheqësia, shërbimi profesional dhe ekipi i vlerësimit të shkollës që është në këtë përbërje:

- Gzime Alili - drejtor
- Fatime Bexheti Durmishi - nëndrejtor dhe mentor i shkollës
- Dugagjin Muharemi - pedagog

Të gjitha aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim me arsimtarët e lëndëve dhe kujdestarët e klasave. Shërbimi profesional përgatit një analizë të rezultateve të nxënësve e cila është pikë e fillimit për analizën e arsimtarëve.

Nga ky vit shkollor bëhet monitorimi dhe vlerësimi i besueshmërisë së vlerësimit nga ana e mësuesve, duke bërë krahasim me të jashtëm dhe të brendshëm (për mësuesit nga klasa e I – deri klasa e III.) Kontrolle të cilësisë dhe objektivitetit me të cilat kanë vlerësuar. Pas marrjes së rezultateve, përgatitet një plan mbështetës për mësuesit që tregojnë më shumë lëshime në vlerësim dhe mbështetje për mësuesit të cilët janë krijues dhe inovatore të zhvillimit të vlerësimit cilësorë. Monitorimi dhe vlerësimi i arsimtarëve është dhënë në bazë të një plani të veçantë, i dhënë në programin vjetor të punës së shkollës.

Planifikimi shkollor për avancimin e vlerësimit në vitin shkollor 2024/2025

Planifikimi i vlerësimit të nxënësve në shkollën tonë ka filluar në viti shkollor 2009/2010, pas vizitave dhe realizimit të trajnimit mbi "Zbatimin e standardeve për vlerësimin e arritjeve të nxënësit" që është realizuar përmes PEP-USAID. Pastaj në 2011/12 ishin mbajtur edhe seminare për vlerësim sumativ të nxënësve. Më tej është krijuar një vlerësim i qartë i politikës në shkollë, apo për të kuptuar të gjithë në shkollë se do të luftohet për vlerësim objektiv, vazhdimësi të vlerësimit, mbështetje për nxënësit për të arritur qëllimet e deklaruara, etika dhe kështu me radhë. Këto përpjekje iu publikuan edhe nxënësve dhe prindërve, dhe në nivel shkolle janë të gjitha aktet e nevojshme siç janë: Kodi për vlerësim, Kriteret e vlerësimit në nivel të shkollës dhe janë vendosur standarde e kritere për çdo lëndë.

Këtë vit planifikim shkollor i vlerësimit vazhdon me arritjet e qëllimeve dhe aktiviteteve të reja që janë ndërmarr. Dhe më tej i bëhet kujdes procesit të plotë:

- planifikimi i vlerësimit;
- Zgjedhja e metodave dhe zhvillimi i instrumenteve për vlerësim;
- Implementimi i procesit të vlerësimit;

- Formimi i notës;
- Informacion për njohuritë nga vlerësimi.

Zbatimi i planifikimit shkollor të vlerësimit filloi me diagnostikimin e situatës, e konsiderimin e kompetencave profesionale të mësimdhënësve dhe identifikimi i prioriteteve të mëtejme.

Pas mbarimit të analizave përkatëse dhe për shkak të përmirësimit të procesit të vlerësimit të nxënësve për vitin shkollor 2024/2025 janë formuluar objektivat e mëposhtme të përgjithshme:

- Avancimi i vazhdimësisë së vlerësimit me theks të veçantë te vlerësimi sumativ me kritere
- Krijimi i një bazë të dhënash që do të përdoret për të monitoruar suksesin e një periudhe të gjatë kohore;

Arritja e objektivave të planifikuara është dhënë në tabelën e mëposhtme me aktivitetet për avancimin e vlerësimit:

Detyra	**MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE**													
Aktiviteti	**Korniza kohore (muaji)**										**Monitorimi**			
	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	**Bartës**	**Mënyra e zbatimit (resurse)**	**Instrumente**	**Personi përgjegjës**
Vlerësimi sumativ numerikisht i të arriturave të nxënësve nga të treshja e dytë (IV - VI)											Mësimdhënës	Prezantim me gojë, diskutime, kontrollime me shkrim aktivitete projektuese, vetë-vlerësim, duke përfshirë vlerësimin e nxënësve, portofol nxënësi	Fletë mësimore, teste kontrolli, detyra projektuese, kuiz - pyetje, detyra shtëpie, lista kontrolli, listat analitike, Lista holistike	Drejtori Nëndrejtor Pedagog
Vlerësimi sumativ numerikisht i të arriturave të nxënësve nga të treshja e tretë (VII, VIII dhe IX)											Mësimdhënës	Përmbledhja e arritjeve të nxënësve gjatë një periudhe, në përputhje me standardet dhe kriteret e vlerësimit	Lista evidentuese për aktivitetet dhe arritje, standarde dhe kriteret e vlerësimit	Drejtori Nëndrejtor Pedagog
Vlerësimi sumativ i të arriturave të nxënësve me kontrollim me shkrim (hartime me shkrim)											Mësimdhënës	Përmbledhja e arritjeve të nxënësve gjatë një periudhe, në përputhje me standardet dhe kriteret e vlerësimit	Lista evidentuese për aktivitetet dhe arritje, standarde dhe kriteret e vlerësimit	Drejtori Nëndrejtor Pedagog

Detyra	MONITORIMI DHE VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE														
Aktiviteti	Korniza kohore (muaji)										Monitorimi				
	9	10	11	12	1	2	3	4	5	6	**Bartës**	**Mënyra e zbatimit (resurse)**	**Instrumente**	**Rezultaet e pritura**	**Personi përgjegjës**
Analiza e arritjeve të nxënësve gjatë vlerësimit të njohurive të jashtme (vlerësimi i jashtëm)											Ekipi vlerësues, Drejtor Nëndrejtor Pedagog kryetarët e aktivëve profesionale	Raport nga komisioni shkollor për kontrollim të jashtëm, raporti vjetor mbi arritjet e nxënësve, analiza vjetor e suksesit të nxënësve për klasë dhe kujdestarve të klasave	Lista e kontrolli t për përjashti me, tabela për llogaritje	Zbulimi i boshllëqeve, detektimi i shkaqeve për kapërcimin e lëshimeve dhe zvogëlimi i lëshimeve gjatë kontrollimit të ardhshëm	Drejtor Nëndrejtor Pedagog
Rishikim i kritereve nga asetet ekzistuese, për vlerësim sipas aktiveve, konform kritereve të BZHA dhe standardeve për lëndë dhe klasë											Aktivet profesionale	Kriteret për vlersim nga BZHA standarte për lëndë dhe klasë, analiza e qëllimeve në nivele	Tabela e ndarjes së qëllimeve në nivele tabela e arritjeve të nxënësve	Vlersimi i rishikuar i kritereve për vlersim sipas lëndëve e reduktimi i gabimeve të bëra gjatë verefikimit të ardhshëm	Drejtor Nëndrejtor Pedagog

